

VENDIM
Nr. 39, datë 10.11.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Illir Toska	anëtar;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Enina Ktoni, në datën 10.11.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 3 (K) 2022 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përfaqësuar nga drejtorja ekzekutive, Erida Skëndaj.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim nga Mimoza Arbi dhe Erind Mërkuri.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim nga Avokatja e Shtetit Irma Qosja.

Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i neneve 89/b dhe 242/a të Kodit Penal, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 17, pika 2, 18, 38, pika 1, 81, pika 2, shkronja “d”, 83, 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pikat 1, shkronjat “h” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 14 dhe 15, pika 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 28, 29, 30, 47, 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit (*KSHH*), i cili kërkonte pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (*Këshilli i Ministrave*), të cilat kërkonin rrëzimin e kërkesës, mendimet me shkrim të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 10.1.2020 në Kuvend është depozituar nga dy deputete projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, i cili synonte ndryshimin e nenit 130/a të Kodit Penal (KP), “Dhuna në familje”.

2. Në vijim, në datën 6.2.2020, Këshilli i Ministrave ka depozituar në Kuvend nismën për një shtesë në KP, me qëllim kriminalizimin e posedimit, përdorimit, mbajtjes ose ruajtjes në mënyrë të pajustificuar të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme për të cilat është vendosur konfiskimi, sipas legjislacionit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

3. Gjatë kohës që projektligji i propozuar nga dy deputetet ishte në proces diskutimi, në datën 8.4.2020, një deputete tjetër, bazuar në nenin 71 të Rregullores së Kuvendit, ka depozituar propozime për amendamente në projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, me qëllim shtimin e dy neneve të reja në KP, përkatësisht nenet 242/1 dhe 242/2, të cilat lidheshin me situatën e pandemisë COVID-19. Pas diskutimeve në komisionin parlamentar përgjegjës u vlerësua që projektligji të përfshinte vetëm propozimet e deputeteve, ndërsa nisma e Këshillit të Ministrave të shqyrtohej më vonë.

4. Në datën 16.4.2020 Kuvendi, mbështetur në nenet 81, pikat 1 dhe 2, shkronja “d” dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, ka miratuar ligjin nr. 35/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (*ligji nr. 35/2020*), i cili është shpallur nga Presidenti i Republikës me dekreten nr. 11463, datë 22.4.2020. Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 23.4.2020 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit.

5. Ligji nr. 35/2020, në përmbajtjen e tij, ka përfshirë propozimet e deputeteve nismëtare për ndryshimin e nenit 130/a (*neni 1*), si dhe shtimin e neneve 242/a (*neni 2*), “Moszbatimi i masave të autoriteteve shtetërore gjatë gjendjes së masave të jashtëzakonshme apo gjatë gjendjes së epidemisë” dhe 89/b (*neni 3*) “Përhapja e sëmundjeve infektive”.

6. Konkretisht, neni 89/b i KP-së “*Përhapja e sëmundjeve infektive*” parashikon se përhapja me dashje e sëmundjes infektive me rrezikshmëri të lartë për shëndetin, nëpërmjet kryerjes së veprimeve ose mosveprimeve nga personi që është diagnostikuar si mbartës i sëmundjes apo nga personi që ka qëllim përhapjen e saj, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Kur kjo vepër është kryer nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin ose rrezik për jetën e njerëzve, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet. Ndërsa neni 242/a i KP-së, “*Moszbatimi i masave të autoriteteve shtetërore gjatë gjendjes së masave të jashtëzakonshme apo gjatë gjendjes së epidemisë*” parashikon se moszbatimi ose kryerja e veprimeve në kundërshtim me aktet ligjore apo nënligjore të nxjerra nga organet shtetërore, në funksion të gjendjes së epidemisë apo të zbatimit të masave të jashtëzakonshme, nga personi, ndaj të cilit është dhënë më parë masë administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj. Po kjo vepër, kur është kryer në ushtrim të aktivitetit tregtar, duke vendosur në rrezik shëndetin e njerëzve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Moszbatimi i urdhrat të dhënë nga organet kompetente për karantinim ose izolimin, apo shkelja e rregullave të karantinës ose të izolimit nga personi mbartës ose jo i sëmundjes infektive, të cilit i është njoftuar ky detyrim nga autoritetet shtetërore përkatëse, dënohet me burgim nga dy deri në tre vjet.

7. Në datën 6.5.2022, KSHH-ja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e neneve 89/b dhe 242/a të KP-së, të shtuara me ligjin nr. 35/2020, përkatësisht nenet 3 dhe 2 të tij, si të papajtueshme me Kushtetutën.

8. Kolegji i Gjykatës në datën 20.6.2022, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. Kërkuesi, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se dispozitat e reja të KP-së të shtuara me ligjin nr. 35/2020 cenojnë:

9.1 Parimin e shtetit të së drejtës, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, që sipas neneve 81, pika 2 dhe 83, pika 3, të saj ndalon miratimin me procedurë të përshpejtuar të ligjeve me shumicë të cilësuar. Ndryshimet në KP janë miratuar nga Kuvendi me procedurë të përshpejtuar, për rrjedhojë ka munguar konsultimi paraprak cilësor dhe në kohë të arsyeshme.

9.2 Parimin e sigurisë juridike, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, pasi dispozitat e kundërshtuara nuk janë të qarta dhe i lënë hapësirë zbatuesit për interpretime të ndryshme. Mungesa e konsultimit paraprak cilësor dhe në afate të arsyeshme cenon elementin e kuptueshmërisë së normës. Ndryshimet ligjore janë miratuar pa një analizë objektive të efikasitetit dhe impaktit të masave të mëparshme. Ligji kërkon respektimin e akteve nga individit, ndërkohë janë miratuar rreth 190 akte të tilla për pandeminë COVID-19, gjë që shkakton paqartësi të ligjit për individin, pasi ai vihet në pamundësi të njohjes së tyre.

9.3 Parimin e barazisë para ligjit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi ndryshimet në KP i trajtojnë njësoj individët mbartës dhe jombartës të sëmundjes infektive si subjekte të përgjegjësisë penale në procedimin penal. Cenimi i këtij parimi nuk justifikohet nga një përligje e arsyeshme dhe objektive. Për më tepër, deri më tani nuk provohet se këto parashikime kanë sjellë dobi të veçantë.

9.4 Për të njëjtat arsye, dispozitat ligjore të kundërshtuara kanë cenuar edhe *të drejtat për të lëvizur lirisht dhe për jetë familjare*, të garantuara respektivisht nga neni 38, pika 1, të Kushtetutës dhe nenet 8, 14 dhe 16 të KEDNJ-së, pasi ndërhyrjet nuk respektojnë *parimin e proporcionalitetit*, të parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës. Ato janë miratuar gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore duke vënë në pikëpyetje respektimin e elementit “nevojë” ose “përshtatshmëri”.

10. Subjekti i interesuar, Kuvendi, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

10.1 Kërkuesi nuk legjitimohet të kundërshtojë procedurën parlamentare të miratimit të ligjit nr. 35/2020, pasi është subjekt me legjitimitet të kushtëzuar dhe nuk provon shkeljen e të drejtave substanciale. Kushtetuta në nenin 170, pikat 5 dhe 6, nuk ndalon ndërhyrjet në KP në kushtet e masave të jashtëzakonshme. Kriminalizimi i sjelljeve të caktuara është e drejtë ekskluzive e Kuvendit, që ushtrohet bazuar në një vlerësim politik dhe nuk mund të kontrollohet nga Gjykata. Po kështu, interpretimi dhe kohezioni i neneve 89/b dhe 242/a, në raport me normat e tjera të KP-së, nuk janë pjesë e juridiksionit të Gjykatës. Veprat e reja penale bazohen në konceptin e zinxhirit të infeksioneve dhe nuk mund të krahasohen me veprat ekzistuese penale.

10.2 Pretendimi për cenimin e procedurës së miratimit të ligjit është i pabazuar, pasi procedura është në përputhje me Kushtetutën. Nisma është paraqitur nga një deputet dhe komisioni parlamentar përgjegjës ka hartuar rregullisht raportin për miratimin e tij. Konsultimi publik nuk është kërkesë kushtetuese. Megjithatë, komisioni parlamentar përgjegjës ka bërë konsultim publik, ku ka përfshirë edhe kërkuesin, që është dokumentuar në raport. Konsultimi ka qenë efikas, pasi disa dispozita janë riformuluar duke u ulur edhe masa e dënimit. Mosreflektimi i të gjitha sugjerimeve nuk i bën normat antikushtetuese.

10.3 Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike, për shkak të paqartësisë së ligjit dhe të akteve nënligjore që miratojnë organet kompetente, është i pabazuar. Ligji hartohet me gjuhë të përgjithshme për t’iu përshtatur zhvillimit shoqëror. Termat në tekstin e ligjit janë të qarta, pasi shpjegohen nga Fjalori i Gjuhës Shqipe ose nga përkufizimet e dhëna në ligje të tjera. Aktet nënligjore nuk krijojnë pasiguri, pasi në bazë të nenit 117 të Kushtetutës publikohen në Fletoren Zyrtare, madje në praktikë ato janë publikuar edhe me forma të tjera të përshtatshme të komunikimit. Kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë se ka pasur individë të penalizuar për shkak të

padijenisë ose aksesit në aktet zyrtare. Fakti që për dy vjet nuk ka individë të dënuar për këto vepra penale, nuk tregon paqartësi të normave, por se nuk ka cenim të të drejtave kushtetuese që pretendohen nga kërkuesi.

10.4 Pretendimi për cenimin e *barazisë para ligjit* është i pabazuar, pasi nuk mban në konsideratë natyrën e kodifikimit të së drejtës penale dhe mënyrën e caktimit të dënimit. Ligjvënësi ka pasur parasysh që dënimi për veprat penale të reja do të individualizohet rast pas rasti sipas Pjesës së Përgjithshme të KP-së.

10.5 Kufizimi i *lirisë së lëvizjes*, por edhe i *lirisë personale* lejohen nga neni 27, pika 2, shkronjat “a” dhe “d”, të Kushtetutës me vendim gjykatë dhe në rastet e sëmundjeve ngjitëse. Ndërsa pretendimi për cenimin e *parimit të proporcionalitetit*, për shkak se vepra penale nuk parashikon ardhjen e pasojës, nuk qëndron, pasi KP-ja përmban edhe vepra të tjera penale formale, tek të cilat nuk kërkohet ardhja e pasojës. Nuk qëndron as pretendimi se sanksionet duhet të përshkallëzohen nga administrative në ato penale si reagim i fundit. Përgjegjësia penale konkurren me atë administrative. Edhe pretendimi se masat kufizuese caktohen *pa ligj* nuk është i bazuar, pasi, siç ka pohuar jurisprudenca kushtetuese, është ligji që vendos kufizimet, ndërsa aktet nënligjore i bëjnë efektive ato.

11. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

11.1 Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi nuk ka argumentuar në mënyrë të plotë dhe të qartë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin është krijuar ose veprimtarisë që kryen; pasojat që rrjedhin nga dispozitat që kërkon të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën dhe efektet që kanë sjellë mbi kërkuesin. Legjitimimi i kërkuesit në çështje kushtetuese të mëparshme nuk do të thotë se ai legjitimohet automatikisht edhe për këtë kërkesë. Ai, në thelb, kundërshton zgjidhjen legjislative të bërë nga ligjvënësi, por mënyra se si Kuvendi zgjedh të adresojë një problematikë të caktuar dhe përshtatshmërinë e masave të ndërmarra, nuk mund të jetë pjesë e juridiksionit kushtetues. E kundërta përbën ndërhyrje të drejtpërdrejtë në kompetencat e Kuvendit.

11.2 Pretendimi për cenimin e *parimit të shtetit të së drejtës* është i pabazuar. Nuk rezulton që ligji të jetë miratuar nga Kuvendi duke zbatuar procedurën e përshpejtuar. Deputetet nismëtare e kanë depozituar projektligjin në datën 10.1.2020 dhe në datën 8.4.2020 janë paraqitur amendamentet nga një deputete tjetër. Ndonëse projektligji dhe ndryshimet e propozuara kanë përmbajtje të ndryshme, masat ishin të pashmangshme, të ngutshme dhe të duhura, pasi Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) shpalli gjendjen e pandemisë COVID-19 dhe në Shqipëri u shpall gjendja e fatkeqësisë natyrore për të njëjtin shkak. Kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë që ligji është miratuar me procedurë të përshpejtuar në Kuvend, nuk është depozituar kërkesë nga Këshilli i Ministrave ose një e pesta e deputetëve për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit dhe në kalendarin e punimeve të Kuvendit nuk rezulton një gjë e tillë.

11.3 Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i paqartë, sepse nuk shoqërohet me prova ose argumente. Dispozitat ligjore janë të qarta dhe të kuptueshme, ato janë riformuluar gjatë procesit legjislativ duke mbajtur në konsideratë edhe legjislacionin penal të një numri shtetesh evropiane. Hapësira e interpretimit që i është lënë prokurorisë dhe gjykatës është e domosdoshme dhe e mjaftueshme, duke lejuar zbatimin e ligjit sipas rrethanave të rasteve konkrete. Dispozitat iu përshtatën pandemisë COVID-19 dhe rasteve të gjendjeve të tjera të jashtëzakonshme ose epidemive të tjera. Ligji iu nënshtrua procesit të konsultimit me 12 institucione, 4 organizata vendase të angazhuara në fushën e të drejtave të njeriut dhe 3 fakultete të Universitetit të Tiranës (të drejtësisë, mjekësisë dhe shkencave sociale). Thirrjes publike për konsultim u janë përgjigjur edhe organizata të tjera, edhe individë të interesuar. Procesi i konsultimit ka qenë efikas, pasi dispozitat ligjore janë rezultat edhe i riformulimeve nga konsultimi me grupet e interesit që kanë përmirësuar qartësinë e tyre.

11.4 Pretendimi për cenimin e *parimit të proporcionalitetit* në raport me lirinë e lëvizjes dhe të *drejtat për barazi* dhe *për një jetë familjare*, nuk bazohet në argumente kushtetuese dhe nuk shoqërohet nga ndonjë provë. Krahasimet e dispozitave të KP-së janë të papërshtatshme, pasi dispozitat ligjore të krahasuara nuk janë të ngjashme. Parashikimi i veprave penale dhe i dënimeve për sjellje që dëmtojnë seriozisht një masë të papërcaktuar të publikut është në diskrecionin e Kuvendit. Trajtimi i njëjtë i individëve mbartës dhe jombartës të sëmundjeve infektive, në kuadër të përgjegjësisë së tyre penale, është mbi baza shkencore, në përputhje me interesin publik të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të publikut në masë të gjerë, si dhe të funksionimit normal të institucioneve të kujdesit shëndetësor. Ai është proporcional, pasi ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive për masat e marra, si dhe nuk cenon ekuilibrin midis qëllimit dhe mjetit të përdorur.

12. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ndonëse u njoftua rregullisht, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim dhe nuk u paraqit në seancë plenare.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuarit

13. Çështjen e legjitimitetit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet e kushtëzuara, që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur.

14. Kërkuari parashtron se legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenin 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës dhe në jurisprudencën e Gjykatës, pasi është shoqatë që ka si qëllim, ndër të tjera, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe zbatimin e parimeve të shtetit ligjor, të cilat, sipas tij, cenohen nga nenet 89/b dhe 242/a të KP-së, prandaj interesi i tij për kundërshtimin e tyre është i justifikuar.

15. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se kërkuari nuk legjitimohet të kundërshtojë procedurën parlamentare të miratimit të ligjit nr. 35/2020, pasi është subjekt me legjitimitet të kushtëzuar dhe nuk provon shkeljen e të drejtave substanciale. Sipas tyre, kërkuari nuk provon lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin është krijuar, veprimtarisë që kryen dhe pasojave që kanë sjellë për të dispozitat ligjore të kundërshtuara. Legjitimimi i kërkuarit në çështje kushtetuese të mëparshme nuk passjell legjitimimin e tij automatik edhe në këtë gjykim. Ai, në thelb, kundërshton zgjidhjen legjislative të bërë nga ligjvënësi, ndërkohë që mënyra se si Kuvendi zgjedh të adresojë një problematikë të caktuar dhe përshtatshmërinë e masave të ndërmarra, përfshirë edhe interpretimin dhe kohezionin e neneve 89/b dhe 242/a në raport me normat e tjera të KP-së, nuk është pjesë e juridiksionit të Gjykatës. E kundërta do të përbënte ndërhyrje të drejtpërdrejtë në kompetencat e Kuvendit. Për më tepër, kriminalizimi i sjelljeve të caktuara është e drejtë ekskluzive e Kuvendit, që ushtrohet bazuar në një vlerësim politik. Veprat e reja penale bazohen në konceptin e zinxhirit të infeksioneve dhe nuk mund të krahasohen me veprat ekzistuese penale.

16. Gjykata vëren se në nenin 131 të Kushtetutës janë parashikuar kompetencat e saj, mes të cilave edhe ajo për kontrollin e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën (*pika 1, shkronja “a”*), ndërsa në nenin 134 parashikohen subjektet që mund ta vënë në lëvizje atë, ku përfshihen edhe organizatat (*pika 1, shkronja “b”*). Këto të fundit, sipas nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, mund të bëjnë kërkesë vetëm nëse provojnë interesin në lidhje me çështjen kushtetuese të ngritur. Përmbajtja e kësaj dispozite kushtetuese është zbërthyer në nenin 49 të ligjit nr. 8577/2000, i cili në pikat 3, shkronja

“d” dhe 4 parashikon se organizatat kanë detyrimin të provojnë në çdo rast se çështja lidhet drejtpërdrejt me të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Kushtetuta ose me qëllimet e veprimtarisë së tyre.

17. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se interesi për të vepruar i subjekteve të kushtëzuara duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka cenuar interesin. Vetëm fakti se dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo për kërkuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që përfshihen në qëllimin e veprimtarisë së tij, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 4, datë 15.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata vëren se kërkuesi është regjistruar si organizatë jofitimprurëse sipas ligjit që në vitin 1991, duke u rikonfirmuar edhe në vitin 2002 me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Duke iu referuar akteve të regjistrimit dhe përmbajtjes së statutit, misioni i tij lidhet me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, zbatimin e parimeve të shtetit ligjor, të cilin e realizon përmes denoncimit të çdo shkeljeje që bie ndesh me legjislacionin shqiptar, si dhe kujdesin për përsosjen e legjislacionit vendas, që garanton të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve. Gjatë gjykimit kushtetues, në seancë plenare publike, kërkuesi parashitroi se qëllimi dhe objekti i organizatës vijnë në të njëjtë të pandryshuar që nga themelimi i tij 32 vjet më parë. Në aktin e themelimit, neni 2, shkronja “a”, organizata ka si objektivin e saj të parë vëzhgimin e gjendjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe zbatimin e parimeve të shtetit ligjor, denoncimin e çdo shkeljeje që bie ndesh me legjislacionin shqiptar dhe normat e së drejtës ndërkombëtare të njohura përgjithësisht. E njëjta klauzolë mishërohet edhe në nenin 2.1., shkronja “a”, të statutit të organizatës.

19. Në parim, Gjykata thekson se vlerësimi nëse një subjekt i kushtëzuar ka interes bëhet sipas rrethanave të veçanta të çdo çështjeje konkrete, pavarësisht nëse subjekti është legjitimuar ose jo në gjykime të tjera kushtetuese. Ashtu siç parashitrojnë subjektet e interesuara, legjitimimi i një subjekti të kushtëzuar nuk merret i mirëqenë për shkak të gjykimeve të mëparshme, por Gjykata i referohet vendimarrjes së atyre rasteve për qëllime të analizës së përmbushjes së kritereve dhe standardeve kushtetuese.

20. Në rastin konkret, dispozitat ligjore të kundërshtuara janë pjesë e KP-së dhe në përmbajtje vendosin përgjegjësinë penale të individëve, ndaj ato lidhen me të drejtat themelore kushtetuese. Në kushtet kur mbrojtja e këtyre të drejtave është objekt i veprimtarisë së kërkuesit, Gjykata vlerëson se ai e justifikon interesin e drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar, në kuptim të nenit 131, shkronja “a”, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 3, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577/2000, rrjedhimisht legjitimohet *ratione personae*.

21. Në vijim, Gjykata, bazuar në nenin 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, çmon se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 35/2020, me të cilin dy dispozitat e kundërshtuara janë bërë pjesë e KP-së. Konkretisht, ligji nr. 35/2020 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 23.4.2020 dhe sipas nenit 4 të tij ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit, pra në datën 8.5.2020, ndërsa kërkesa për kontroll kushtetues për dispozitat konkrete të tij është paraqitur në datën 6.5.2022.

22. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, se dispozitat ligjore të kundërshtuara cenojnë në mënyrë joproporcionale të drejtën për jetë familjare, të garantuar nga neni 8 i KEDNJ-së, duke argumentuar gjatë shpjegimeve në seancë plenare se ato parashikojnë dënim me burgim dhe ngarkojnë me përgjegjësi penale edhe individin jombartës, i cili përkujdeset

për anëtarët e sëmure të familjes. Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka parashtruar argumente kushtetuese konkrete dhe të mjaftueshme që të mbështesin këtë pretendim të tij, për rrjedhojë ai nuk është ngritur në nivel kushtetues.

23. Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e parimit të shtetit të së drejtës për shkak të miratimit me procedurë të përsheptuar të ligjit me shumicë të cilësuar dhe të parimeve të sigurisë juridike, si dhe të proporcionalitetit në kufizimin e barazisë para ligjit dhe të lirisë së lëvizjes. Për këtë të fundit, kërkuesi i referohet nenit 38 të Kushtetutës, duke paraqitur si argument faktin se dispozitat ligjore të kundërshtuara parashikojnë dënimin me burgim të individëve. Për rrjedhojë, Gjykata, bazuar në parimin *iura novit curia*, do ta vlerësojë këtë pretendim sipas nenit 27 të Kushtetutës, që garanton lirinë personale, duke parashikuar, njëkohësisht, kufizimin e saj me vendim të gjykatës kompetente. Po kështu, Gjykata rithekson se kur kontrollohen aktet e pushtetit publik, sa herë që vihet në diskutim një e drejtë kushtetuese ose liri themelore, është me rëndësi të verifikohen parimet që lidhen me cilësinë e ligjit, parashikueshmërinë, sigurinë juridike dhe barazinë para ligjit, pasi janë pikërisht ato që mbrojnë individin nga arbitrariteti, veçanërisht në marrëdhëniet ndërmjet tij dhe shtetit (*shih vendimin nr. 30, datë 2.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata do ta vlerësojë pretendimin për cenimin e parimeve të sigurisë juridike dhe të barazisë para ligjit, si parime që lidhen me cilësinë e ligjit që pretendohet se kufizon lirinë personale.

24. Për sa më lart, Gjykata, duke theksuar se pretendimet që lidhen me aspektet procedurale, në rastin e subjekteve të kushtëzuara, shqyrtohen për aq sa ato përligjin interesin e kërkuesit për cenimin e të drejtave themelore (*shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2011, të Gjykatës Kushtetuese*), çmon se pretendimet e kërkuesit hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj në vijim do të shqyrtojë bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë personale

25. Kërkuesi ka pretenduar se dispozitat ligjore të kundërshtuara nuk respektojnë parimin e proporcionalitetit, të parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës, pasi cenojnë në mënyrë joproporcionale lirinë personale. Gjithashtu, ato cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike, pasi nuk janë në koherencë me dispozitat e tjera të KP-së për vepra penale të ngjashme, si dhe nuk kanë formulim të qartë. Janë miratuar rreth 190 akte nënligjore për pandeminë COVID-19 dhe individë vihet në pamundësi të njohjes së tyre. Kjo shkakton paqartësinë e ligjit, i cili kërkon nga individë respektimin e akteve nënligjore. Dispozitat ligjore janë miratuar gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe me urgjencë, pa vlerësim paraprak të efikasitetit të masave të tjera të marra nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi. Për pasojë, kriminalizimi në legjislacionin penal i sjelljeve të lidhura me pandeminë COVID-19 ishte i parakohshëm dhe në kundërshtim me parimet dhe të drejtat kushtetuese. Shteti ka në dispozicion mënyra më pak kufizuese për të arritur qëllimin për respektimin e legjislacionit gjatë pandemisë. Para se të kufizonte lirinë personale, shteti mund të parashikonte përkallëzim të masave administrative, ndalimi duhet të jetë masa e fundit, kur të gjitha masat e tjera rezultojnë jo efektive. Ligjvënësi, duke mos pasur mundësi të përcaktojë detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor i pandemisë, ka krijuar premisa për pasiguri dhe trajtim të diferencuar të individëve.

26. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi dënimi për veprat penale të reja do të individualizohet rast pas rasti sipas Pjesës së Përgjithshme të KP-së. Kufizimi i lirisë së lëvizjes lejohet nga neni 27, pika 2, shkronjat “a” dhe “d”, të Kushtetutës, pra me vendim gjykate dhe në rastet e sëmundjeve ngjitëse. Edhe pretendimi se vepra penale është antikushtetuese se nuk parashikon ardhjen e pasojës, nuk qëndron, pasi KP-ja përmban edhe vepra të tjera penale formale, tek të cilat nuk kërkohet ardhja e pasojës. Përgjegjësia penale konkurron me atë administrative, ndaj është i pabazuar pretendimi se sanksionet duhet të përshkallëzohen nga administrative në ato penale si reagim i fundit. Masat kufizuese janë caktuar me ligj, pasi siç ka

pohuar jurisprudenca kushtetuese është ligji që vendos kufizimet, ndërsa aktet nënligjore i bëjnë efektive ato. Ligji është hartuar me gjuhë të përgjithshme për t'iu përshtatur zhvillimit shoqëror. Termat në tekstin e tij janë të qarta, pasi shpjegohen nga Fjalori i Gjuhës Shqipe ose nga përkufizimet e dhëna në ligje të tjera. Ndërsa aktet nënligjore nuk krijojnë pasiguri, pasi në bazë të nenit 117 të Kushtetutës publikohen në Fletoren Zyrtare, madje në praktikë ato janë publikuar edhe me forma të tjera të përshtatshme të komunikimit. Kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë se ka pasur individë të penalizuar për shkak të padijenisë ose aksesit në aktet zyrtare. Fakti që për dy vjet nuk ka individë të dënuar për këto vepra penale nuk tregon paqartësi të normave, por tregon se nuk ka cenim të të drejtave kushtetuese që pretendohen nga kërkuesi.

27. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e parimit të proporcionalitetit në kufizimin e këtyre të drejtave kushtetuese, nuk bazohet në argumente kushtetuese dhe nuk shoqërohet nga ndonjë provë. Krahasset e dispozitave të KP-së janë të papërshtatshme, pasi dispozitat ligjore të krahasuara nuk janë të ngjashme. Parashikimi i veprave penale dhe i dënimeve për sjellje që dëmtojnë seriozisht një masë të papërcaktuar të publikut është në diskrecionin e Kuvendit.

28. Neni 27 i Kushtetutës garanton lirinë personale, e cila mund të kufizohet vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht në pikën 2 të tij, ku, ndër të tjera, përfshihen dënimi i individit me burgim nga gjykata kompetente (*shkronja "a"*) ose rasti i individit që është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paafte mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë (*shkronja "d"*).

29. Duke mbajtur në konsideratë se liria personale mbrohet edhe nga neni 5 i KEDNJ-së, Gjykata i referohet edhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka theksuar se qëllimi kryesor i kësaj dispozite është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë (*shih vendimet Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2) [GC], viti 2020, § 311; S., V. dhe A. kundër Danimarkës [GC], viti 2018, § 73*). E drejta për liri dhe siguri është e një rëndësie jetike për një “shoqëri demokratike” (*shih vendimet Medvedyev and Others v. France [GC], viti 2010, § 76; Ladent v. Poland, viti 2008, § 45*). Në rastet që kanë të bëjnë me heqjen e lirisë, është veçanërisht e rëndësishme që të respektohet parimi i përgjithshëm i sigurisë juridike. Për këtë arsye, është thelbësore që kushtet për heqjen e lirisë të jenë qartësisht të përcaktuara sipas ligjit të brendshëm dhe që vetë ligji të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që ai të përmbushë standardin e “ligjshmërisë” të përcaktuar nga Konventa, një standard i cili kërkon që ligji të jetë mjaftueshëm i qartë për t'i mundësuar individit – nëse është e nevojshme, me këshillën e duhur – që të parashikojë, në një shkallë të arsyeshme në rrethanat, pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar (*shih vendimet Khlaifia dhe të tjerët kundër Italisë [GC], viti 2016, § 92; Del Río Prada kundër Spanjës [GC], viti 2013, § 125; Creangă v. Romania, viti 2012, § 120; Medvedyev and Others v. France [GC], viti 2010, § 80*). Prandaj, neni 5 § 1 nuk i referohet thjesht ligjit të brendshëm, ai lidhet, gjithashtu, me “cilësinë e ligjit” që nënkupton se, në rastet kur ligji vendos autorizon heqjen e lirisë, ai duhet të jetë mjaftueshëm i aksesueshëm, i saktë dhe i parashikueshëm në zbatimin e tij. Faktorët që lidhen me këtë vlerësim të “cilësisë së ligjit” – të cilët në disa raste referohen si “mbrojtje kundër arbitraritetit” – duhet të përfshijnë ekzistencën e dispozitave të qarta ligjore për urdhërimin e ndalimit, zgjatjen e ndalimit dhe përcaktimin e afateve të ndalimit, si dhe ekzistencën e një mjeti ligjor efektiv, nëpërmjet të cilit kërkuesi mund të kundërshtojë “ligjshmërinë” dhe “kohëzgjatjen” e vazhdimit të ndalimit të tij (*shih vendimin J.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar, viti 2016, § 77*).

30. Gjykata vëren se nenet 89/b dhe 242/a të KP-së parashikojnë kriminalizimin e sjelljes dhe dënimin me burgim të individit, që shkakton përhapjen e sëmundjes infektive dhe passjell dëmtimin e shëndetit dhe të jetës së personave të tjerë. Duke parashikuar dënim me burgim, i cili jepet me anë të një procesi të rregullt ligjor, me vendim të gjykatës kompetente, është e qartë që dispozitat ligjore përbëjnë bazën juridike për të kufizuar lirinë personale të individit, sipas rastit, të lejuar nga neni 27,

pika 2, shkronja “d”, i Kushtetutës. Në këtë kuptim, është e nevojshme të shqyrtohet nëse ky kufizim respekton kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, pra nëse kufizimi është bërë vetëm me ligj, nëse ekziston interesi publik dhe nëse përpjesëtimi midis ndërhyrjes dhe gjendjes që e ka diktuar atë është i drejtë.

31. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se qëllimi i kriterit “*kufizimi vetëm me ligj*” sipas nenit 17 të Kushtetutës, është ofrimi i garancive sa më të plota në rastin e kufizimeve dhe, për këtë shkak, vetëm organi më i lartë ligjvënës duhet të jetë kompetent. Shprehja “*vetëm me ligj*” ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në çmim të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera. Kufizimi i të drejtave dhe i lirive vetëm me ligj të referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla cenon kompetencat e këtij organi (*shih vendimet nr. 30, datë 2.11.2022; nr. 25, datë 28.4.2014; nr. 20, datë 4.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Gjykata ka theksuar se kur kontrollohet kushtetutshmëria e ndërhyrjeve në të drejtat e njeriut, vlerësimi i kriterit “*kufizimi vetëm me ligj*” analizohet si në aspektin formal, në kuptimin nëse ndërhyrja parashikohet nga ligji i miratuar nga Kuvendi, ashtu edhe në aspektin substancial, në kuptimin se sa ligji ofron garancitë e mjaftueshme për ndërhyrjen (*shih vendimin nr. 30, datë 5.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i takon aspektit substancial, Gjykata ka pohuar se ligji që kufizon të drejtat kushtetuese duhet të përmbushë kërkesat e cilësisë: ai duhet të jetë i aksesueshëm për të interesuarin (në kuptim të marrjes dijeni) dhe i parashikueshëm për efektet e tij. Po kështu, ligji duhet të jetë mjaftueshmërisht i qartë, me qëllim që t’u japë qytetarëve një tregues të përshtatshëm për rrethanat dhe kushtet në të cilat autoritetet publike janë të autorizuar të ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese të tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 2.11.2022; nr. 30, datë 5.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se legjislacioni penal është tregues kuptimplotë për çdo vend, në kuptimin se sa ai është në gjendje të balancojë të drejtën e shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, me të drejtat dhe liritë e individit, nga ana tjetër. Duke pasur parasysh rëndësinë që ka legjislacioni penal dhe sidomos efektin e dënimeve penale mbi të drejtat e njeriut, normat penale duhet të jenë të parashikueshme dhe të qarta. Me fjalë të tjera, standardet për saktësinë e ligjit janë të rëndësishme për ligjin penal, pasi krijojnë lidhje të drejtpërdrejtë me dy prej parimeve kryesore të së drejtës penale, siç janë parimi i ligjshmërisë (mosdënimi penalisht për vepra që nuk parashikohen shprehimisht në ligj) dhe ndalimi i zbatimit të ligjit penal me analogji (*shih vendimin nr. 24, datë 4.5.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se nenet 89/b dhe 242/a janë shtuar në KP me ligjin nr. 35/2020 të miratuar nga Kuvendi, ndaj në rastin konkret merr rëndësi të analizohet nëse është përmbushur aspekti substancial i kriterit “*kufizimi vetëm me ligj*”.

35. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se neni 89/b i KP-së titullohet “*Përbapja e sëmundjes infektive*” dhe nga pikëpamja sistematike është vendosur në Kreun II “*Veprat penale kundër personit*”, në Seksionin III “*Veprat penale të kryera me dashje kundër shëndetit*”. Kjo do të thotë se ligjvënësi e ka klasifikuar këtë vepër penale tek ato që dëmtojnë me dashje shëndetin e personave të tjerë.

36. Neni 89/b i KP-së është strukturuar në tre paragrafë të ndarë, ku paragrafi i parë parashikon veprën penale të përhapjes me dashje të sëmundjes infektive, të rrezikshme për shëndetin, e cila mund të kryhet nga mbartësi i sëmundjes ose nga një person që thjesht ka si qëllim përhapjen e saj. Paragrafi i parë i kësaj dispozite bën fjalë për vepër penale të kryer në çdo rast me dashje, që përputhet edhe me vendosjen sistematike të nenit 89/b në KP, si dhe nuk paraqet probleme të nivelit kushtetues në drejtim të qartësisë së tekstit të saj.

37. Gjykata vëren se në paragrafin e dytë neni 89/b parashikon, se “*kur kjo vepër është kryer nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet*”. Ky formulim e nxjerr veprën penale nga sistemi i atyre të kryera me dashje, pa dhënë ndonjë arsye se përse nuk është vendosur te Seksioni IV, i cili

përmbledh veprat penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia. Ndonëse në vetvete, pozicionimi sistematik i një dispozite ligjore nuk përbën argument të mjaftueshëm për antikushтетutshmërinë e saj, Gjykata vëren se në rastin konkret ky formulim nuk i jep përgjigje të saktë as çështjes së përgjegjësisë penale të individit. Togfjalëshi “*kur kjo vepër*” nuk kuptohet nëse i referohet përmbajtjes së paragrafit të parë të nenit 89/b ose vetëm titullit të tij. Nëse ajo i referohet përmbajtjes së paragrafit të parë, atëherë është e paqartë se si mund të kryhet nga pakujdesia vepra penale e përhapjes së sëmundjes infektive të rrezikshme nga personi që ka për qëllim përhapjen e saj, ndërsa nëse i referohet thjesht dhe vetëm titullit “*Përhapja e sëmundjes infektive*”, atëherë është e paqartë nëse bëhet fjalë për çdo lloj sëmundje infektive ose vetëm për ato të rrezikshmet. Po kështu, duke pasur parasysh kuptimin e fajit në formën e pakujdesisë, formulimi i krijon individit pasiguri për masat që duhet të marrë për të kontrolluar shëndetin dhe diagnostikimin e sëmundjeve eventuale epidemike, që të provojë se nuk ka pasur mundësi as të parashikonte dhe as të dëshironte përhapjen e sëmundjeve infektive. Me fjalë të tjera, nga ky formulim nuk kuptohet se si individit duhet të veprojë për të parashikuar mundësinë e ardhjes së pasojës penale – përhapjen e sëmundjes infektive, me qëllim shmangien e përgjegjësisë penale.

38. Gjykata konstaton paqartësi edhe në përmbajtjen e paragrafit të tretë të nenit 89/b, i cili parashikon se “*po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin ose rrezik për jetën e njerëzve, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet*”. Togfjalëshi “*po kjo vepër*” në këtë paragraf është sërish i paqartë nëse i referohet veprës penale të paragrafit të parë, veprës penale të paragrafit të dytë ose thjesht titullit të të gjithë nenit. Nëse i referohet paragrafit të parë, atëherë është e paqartë se ku ndryshojnë këto dy vepra penale nga njëra-tjetra, në kushtet kur sëmundja infektive me rrezikshmëri të lartë për shëndetin nëse përhapet do të shkaktojë pasoja të rënda për shëndetin ose rrezik për jetën e njerëzve. Ndërsa nëse i referohet paragrafit të dytë ose titullit të nenit 89/b, atëherë lindin të njëjtat paqartësi të evidentuara gjatë analizës së paragrafit të dytë.

39. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 89/b të KP-së, për shkak të paqartësive në formulim, nuk plotësojnë aspektin substancial të kriterit kushtetues “*kufizimi vendoset vetëm me ligj*” të nenit 17 të Kushtetutës. Duke mbajtur në konsideratë se mosplotësimi edhe vetëm i një kriteri e bën ligjin të papajtueshëm me Kushtetutën, Gjykata vlerëson të mos analizojë më tej kriteret e tjera për këta dy paragrafë.

40. Lidhur me nenin 242/a të KP-së, Gjykata vëren se ai përfshihet në seksionin I “*Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasi*”, pjesë e kreut VIII “*Krime kundër autoritetit të shtetit*” dhe ka në thelb mbrojtjen e autoritetit shtetëror nëpërmjet ndëshkimit të sjelljeve, veprimeve dhe mosveprimeve që vijnë si pasojë e mosrespektimit të akteve ligjore dhe nënligjore. Dispozita emërtohet “*Moszbatimi i masave të autoriteteve shtetërore gjatë gjendjes së masave të jashtëzakonshme apo gjendjes së epidemisë*” dhe ka në përmbajtje 3 paragrafë. Në paragrafin e parë ligjvënësi ka sanksionuar moszbatimin ose kryerjen e veprimeve në kundërshtim me aktet ligjore apo nënligjore të nxjerra nga organet shtetërore, në funksion të gjendjes së epidemisë apo të zbatimit të masave të jashtëzakonshme, nga personi, ndaj të cilit është dhënë më parë masë administrative, sjellje që përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj. Në paragrafin e dytë ka përcaktuar se nëse kjo vepër penale është kryer në ushtrim të aktivitetit tregtar, duke vendosur në rrezik shëndetin e njerëzve, sjellja dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet. Ndërsa në paragrafin e tretë ka përcaktuar se moszbatimi i urdhrat të dhënë nga organet kompetente për karantinim ose izolim, apo shkelja e rregullave të karantinës ose të izolimit nga personi mbartës ose jo i sëmundjes infektive, të cilit i është njoftuar ky detyrim nga autoritetet shtetërore përkatëse, dënohet me burgim nga 2 deri në 3 vjet.

41. Gjykata vëren se përmbajtja e kësaj dispozite në raport me normat e tjera të këtij seksioni të KP-së, që sanksionojnë sjelljet që thyejnë ose kundërshtojnë autoritetin shtetëror, nuk paraqet

probleme të nivelit kushtetues në drejtim të qartësisë së tekstit të saj dhe pasigurisë juridike. Në këtë analizë, Gjykata çmon se argumenti i kërkuarit, i mbështetur edhe nga Avokati i Popullit në mendimin me shkrim, se gjatë periudhës së pandemisë mars – dhjetor 2020, autoritetet publike nxorën rreth 190 akte ligjore dhe nënligjore, një pjesë e të cilave u publikuan edhe me vonesë nuk lidhet drejtpërdrejt me qartësinë e nenit 242/a të KP-së nga pikëpamja kushtetuese, por me sjelljen konkrete të autoriteteve publike për përballimin e pandemisë COVID-19. Për sa i takon kësaj të fundit, Gjykata ka theksuar se autoritetet publike duhet t'i justifikojnë publikisht aktet nënligjore, duke dhënë detaje për shkakun, objektin dhe qëllimin, që në një term të vetëm nënkupton "*ratio legis*", si dhe duke vënë në dispozicion të publikut informacionin e duhur, përfshirë edhe informacionin se si kufizimet janë në përputhje me kërkesat e parimeve kushtetuese të ligjshmërisë, barazisë dhe proporcionalitetit. Po kështu, raportimi periodik përpara legjislativit i autoriteteve publike që marrin këto masa kufizuese i shërben shtetit të së drejtës, në të cilin pushteti legjislativ, ndër të tjera, kontrollon dhe garanton përgjegjshmërinë e organeve të ekzekutivit (*shih vendimin nr. 11, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kjo dispozitë e përmbush aspektin substancial të kriterit "*kufizimi vendoset vetëm me ligj*".

42. Lidhur me kriterin tjetër kushtetues të nenit 17 të Kushtetutës, që ka të bëjë me përligjjen e ndërhyrjes për shkak të interesit publik, kërkuari nuk ka ngritur ndonjë pretendim në këtë drejtim. Ndërsa subjekti i interesuar, Kuvendi, ka parashtruar se interesi publik i këtyre dispozitave tejkalon situatën e pandemisë COVID-19, pasi, aktualisht, gjashtë prej sëmundjeve epidemike/pandemike vijojnë të jenë ende aktive, duke shkaktuar pasoja të rënda në shëndetin botëror.

43. Gjykata vëren se megjithëse shkak për përfshirjen e neneve 89/b dhe 242/a në KP, të miratuara me ligjin nr. 35/2020, u bë pandemia e shkaktuar nga COVID-19, mënyra e formulimit të tyre është bërë për t'iu përgjigjur të gjitha situatave të sëmundjeve epidemike ose pandemike. Gjykata ka pranuar se "*mbrojtja e shëndetit*" të qytetarëve është një nga "*qëllimet legjitime*" që mundëson ndërmarrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive me rrezikshmëri të lartë, po kuptohet, vetëm nëse ato janë të "*përcaktuara në ligj*" dhe "*të domosdoshme në një shoqëri demokratike*" (*shih vendimin nr. 11, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Duhet evidentuar se neni 242/a i KP-së sanksionon penalisht edhe individin që nuk zbaton masat e jashtëzakonshme, të cilat, sipas nenit 170, pika 1, të Kushtetutës, mund të vendosen për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe zgjasin për aq kohë sa vazhdojnë këto gjendje. Gjykata, duke konsideruar natyrën dhe qëllimin e masave të jashtëzakonshme, vëren se, në këto raste, neni 242/a synon qëllimin legjitim të mbrojtjes së rendit dhe sigurisë publike. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kufizimi i lirisë personale nga të dyja dispozitat e kundërshtuara përligjet nga ekzistenca e interesit publik, që lidhet me mbrojtjen e shëndetit, të rendit dhe të sigurisë publike.

44. Kriteri tjetër për kufizimin e të drejtave themelore, bazuar në nenin 17 të Kushtetutës, është ai i proporcionalitetit, që ka të bëjë me përpjesëtimin e drejtë që duhet të ekzistojë midis ndërhyrjes dhe gjendjes që e dikton atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave, e, në asnjë rast, nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

45. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 1, datë 6.2.2013; nr. 52, datë 5.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Ndonëse institucionet publike kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi për të caktuar kufizime të të drejtave themelore, këto kufizime i nënshtrohen shqyrtimit të Gjykatës në drejtim të përputhshmërisë së tyre me Kushtetutën, duke vlerësuar rrethanat konkrete të rastit, duke analizuar "*ndërhyrjen*" nën dritën e çështjes në tërësi dhe duke përcaktuar nëse ajo ka ndjekur një "*qëllim legjitim*", nëse i është përgjigjur "*nevojës reale të*

ndërhyrjes” dhe, në veçanti, nëse ka qenë proporcionale me qëllimin, si dhe nëse arsyet e përdorura nga institucionet publike për ta justifikuar atë kanë qenë “*të rëndësishme dhe të mjaftueshme*” (*shih vendimet nr. 15, datë 22.6.2022; nr. 20, datë 20.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Gjykata rithekson se për vlerësimin e proporcionalitetit duhen mbajtur në konsideratë disa kritere: i. nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii. nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii. nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhet për të arritur objektivin e kërkuar, sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t’u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 11, datë 9.3.2021; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se, në thelb, masat penalizuese nëpërmjet dënimit me burgim për shkak të thyerjes së rregullave të nxjerra gjatë periudhës së një pandemie lidhen në mënyrë të arsyeshme me objektivin e ligjvënësit për të parandaluar dhe ndëshkuar sjelljet e individit që vënë në rrezik shëndetin dhe jetën e njerëzve nga sëmundjet infektive ose rendin dhe sigurinë publike gjatë gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

48. Në analizë të marzheve të dënimit që parashikojnë nenet 89/b, paragrafi i parë dhe 242/a të KP-së, Gjykata vëren se përhapja me dashje e sëmundjes infektive me rrezikshmëri të lartë për shëndetin dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet (*paragrafi i parë i nenit 89/b*); moszbatimi ose kryerja e veprimeve në kundërshtim me aktet ligjore apo nënligjore të nxjerra nga organet shtetërore gjatë gjendjes së masave të jashtëzakonshme ose të epidemisë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj (*paragrafi i parë i nenit 242/a*); kur vepra penale është kryer në ushtrim të aktivitetit tregtar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet (*paragrafi i dytë i nenit 242/a*); moszbatimi i urdhrat të dhënë nga organet kompetente për karantinim ose izolim, apo shkelja e rregullave të karantinës ose të izolimit nga personi mbartës ose jo i sëmundjes infektive dënohet me burgim nga dy deri në tre vjet (*paragrafi i tretë i nenit 242/a*).

49. Duke analizuar përmbajtjen e dispozitave, Gjykata konstaton se paragrafi i parë i nenit 89/b, si dhe paragrafët e parë dhe të dytë të nenit 242/a të KP-së përcaktojnë për veprat penale dënime me marzh të diferencuar ose lloje të ndryshme dënimi (me gjobë ose me burgim) në raport të drejtë me faktet penale, subjektet dhe pasojat formale ose materiale të veprave penale të parashikuara, duke u lidhur në mënyrë të arsyeshme me qëllimin legjitim që ka synuar të përmbushë ligjvënësi. Ndërsa për sa i përket paragrafit të tretë të nenit 242/a, Gjykata vëren se ai parashikon vetëm dënim nga 2 gjer në 3 vjet burgim, i cili lidhur me rrethanat e ndryshme në të cilat kryhet kjo vepër, përfshirë edhe kategoritë e ndryshme të subjekteve të veprave penale, e bën të nevojshme analizën kushtetuese të tij, në raport edhe me pretendimin e kërkuar për cenimin e barazisë para ligjit, për të konkluduar nëse në këtë rast kufizimi i lirisë personale mbart tipare të arbitraritetit.

50. Në përmbajtjen e tij, neni 242/a, paragrafi i tretë, i KP-së parashikon sanksionin penal vetëm me burgim si për individët mbartës, ashtu edhe për ata jombartës, pra për dy kategori të ndryshme subjektësh. Njëherazi, kjo dispozitë penale flet për rrethanat e karantinimit ose të izolimit, të cilat janë të ndryshme objektivisht. Më konkretisht, referuar ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, “*karantina*” është kufizimi i lëvizjeve të njerëzve të shëndetshëm, të cilët kanë qenë në kontakt me të sëmurët ose burimin e infeksionit të sëmundjeve infektive të rrezikshme dhe qëndrimi i tyre në një mjedis të caktuar, ndërsa “*izolimi*” është izolimi i personave të dyshuar apo të mundshëm për prekje nga infeksione apo sëmundjet infektive, si dhe personave të infektuar nga të shëndetshmit, për të penguar përhapjen e

infeksionit. Në këtë drejtim, situata “*izolim*” me “*karantinim*” nuk është e njëjtë dhe po kështu edhe “*personi mbartës*” dhe “*personi jombartës*” janë kategori të ndryshme.

51. Jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përligjet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet (*shih vendimet nr. 34, datë 10.4.2017; nr. 10, datë 29.2.2016; nr. 4, datë 12.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Në mendimet e tyre me shkrim, Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kanë evidentuar se në nenin 242/a të KP-së barazohet mbartësi i sëmundjes me atë që nuk është mbartës. Në këtë situatë krijohet dyshimi i arsyeshëm se *prima facie* kjo dispozitë vendos në pozitë më pak të favorshme për sa i përket dënueshmërisë në proporcion me pasojat e veprës personin jombartës të sëmundjeve infektive në raport me personin mbartës të tyre.

53. Gjykata vëren se paragrafi i tretë i nenit 242/a të KP-së përcakton dënimin me burgim me marzh dënimi nga dy gjer në tre vjet, si personin mbartës, ashtu edhe atë jombartës të sëmundjes infektive, si kur shkel rregullat e karantinës, ashtu edhe ato të izolimit. Megjithatë, duhet evidentuar se element përcaktues i përgjegjësisë penale dhe i dënimit për individin jombartës është njoftimi paraprak i detyrimit për karantinim ose izolim nga autoriteti shtetëror kompetent. Nga analizimi në tërësi i këtyre të dhënave, Gjykata vlerëson se ndërhyrja e ligjvënësit është realizuar përmes një mase që lejon të merren në konsideratë karakteristikat e ndryshme të kategorive të ndryshme të individëve – mbartës dhe jombartës, si dhe ndryshimet midis individëve në karantinë me individët në izolim, ndaj kufizimi nuk rezulton të jetë i paarsyeshëm, i padrejtë dhe joproporcional.

54. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale nga mosrespektimi i kriterëve të nenit 17 të Kushtetutës, është i bazuar vetëm për pjesët që lidhen me përmbajtjen e paragrafëve të dytë dhe të tretë të nenit 89/b, të cilat duhet të shfuqizohen si të papajtueshme me Kushtetutën.

B.2. Për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës

55. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të shtetit të së drejtës, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, duke paraqitur dy shkaqe kushtetuese. Shkaku i parë, lidhet me faktin se ndryshimet e KP-së janë miratuar nga Kuvendi me procedurë të përshpejtuar në shkelje të neneve 81, pika 2 dhe 83, pika 3 të Kushtetutës. Ndërsa shkaku i dytë lidhet me cenimin e parimit të sigurisë juridike si pasojë e mungesës së konsultimit në procedurën parlamentare, e cila ka shkelur elementin e kuptueshmërisë, pasi kontributi i publikut dhe grupeve të interesit mund të ndikonte në hartimin e dispozitave më të qarta dhe të kuptueshme për të gjithë qytetarët dhe institucionet që kanë detyrimin t'i respektojnë dhe zbatojnë këto dispozita ligjore. Sipas kërkuesit, ndryshimet ligjore janë miratuar pa një analizë objektive të efikasitetit dhe impaktit të masave të mëparshme.

56. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës është i pabazuar. Sipas tij, procedura e miratimit të dispozitave të kundërshtuara është në përputhje me Kushtetutën. Nisma është paraqitur nga një deputet dhe komisioni parlamentar përgjegjës ka hartuar rregullisht raportin për miratimin e tij. Konsultimi publik nuk është kërkesë kushtetuese. Lidhur me cenimin e parimit të sigurisë juridike, Kuvendi, ka prapësuar se komisioni përgjegjës ka bërë konsultim publik, ku ka përfshirë edhe kërkuesin, që është dokumentuar në raport. Konsultimi ka qenë efikas, pasi disa dispozita janë riformuluar duke u ulur edhe masa e dënimit. Mosreflektimi i të gjitha sugjerimeve nuk i bën normat antikushtetuese.

57. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim të kërkuesit, pasi sipas tij nuk rezulton që ligji të jetë miratuar nga Kuvendi duke zbatuar procedurën e

përsheptuar. Deputetet nismëtare e kanë depozituar projektligjin në datën 10.1.2020 dhe në datën 8.4.2020 janë paraqitur amendamentet nga një deputete tjetër. Ndonëse projektligji dhe ndryshimet e propozuara kanë përmbajtje të ndryshme, masat ishin të pashmangshme, të ngutshme dhe të duhura, pasi OBSH-ja shpalli gjendjen e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19 dhe në Shqipëri u shpall gjendja e fatkeqësisë natyrore për të njëjtin shkak. Kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë që ligji është miratuar me procedurë të përsheptuar. Në Kuvend nuk është depozituar kërkesë nga Këshilli i Ministrave ose një e pesta e deputetëve për shqyrtimin me procedurë të përsheptuar të projektligjit dhe në kalendarin e punimeve të Kuvendit nuk rezulton një gjë e tillë. Po kështu, nisma u konsultua me 12 institucione, 4 organizata vendase të angazhuara në fushën e të drejtave të njeriut dhe 3 fakultete të Universitetit të Tiranës, organizata të shoqërisë civile dhe individë të interesuar, përfshirë edhe kërkuesin. Gjithashtu, dispozitat ligjore janë të qarta dhe të kuptueshme, ato janë riformuluar gjatë procesit legjislativ duke mbajtur në konsideratë edhe legjislacionin penal të një numri shtetesh evropiane. Hapësira e interpretimit që i është lënë prokurorisë dhe gjykatës është e domosdoshme dhe e mjaftueshme, duke lejuar zbatimin e ligjit sipas rrethanave të rasteve konkrete. Dispozitat i përshtaten pandemisë COVID-19 dhe rasteve të gjendjeve të tjera të jashtëzakonshme ose të epidemive të tjera.

58. Në mendimin me shkrim, Avokati i Popullit është shprehur se ndryshimet e KP-së janë masë e jashtëzakonshme për t'iu përgjigjur gjendjes së shkaktuar nga COVID-19. Ato ishin të ndaluara, sipas nenit 170, pika 5, të Kushtetutës. Kjo dispozitë kushtetuese garanton shtetin e së drejtës gjatë periudhës së jashtëzakonshme, gjatë së cilës ulen mbrojtja dhe mekanizmat kontrollues të çdo sistemi, për të mos lejuar abuzime nga autoriteti shtetëror ndaj lirisë dhe sigurisë së individit. Për këtë arsye, çdo veprimtari legjislativ gjatë asaj periudhe duhej t'i nënshtrohej parimit të legjitimitetit dhe proporcionalitetit. Nuk mundet që gjatë një periudhe të jashtëzakonshme të miratohen ligje me karakter të përhershëm. Ato duhet të bëheshin mbi bazën e një diskutimi shumë të gjerë në publik, të ishin të mirëmenduara dhe me një optikë afatgjatë. Detyrimi i konsultimit publik buron nga parimi themelor i sovranitetit i parashikuar në nenin 2, pika 1, të Kushtetutës, i cili i përket popullit. Këshilli i Evropës ka udhëzuar se gjatë krizës së COVID-19 shtetet duhet të minimizojnë aktivitetin legjislativ në masën e domosdoshme për të adresuar gjendjen në të cilën ndodhet shteti.

59. Për sa i përket vlerësimit të këtij pretendimi, në përfundim të diskutimeve, në zbatim të nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000. Kështu, sipas njërit qëndrim u vlerësua se ligji nr. 35/2020, duke përfshirë edhe dy dispozitat ligjore të kundërshtuara, përbën një nismë të vetme në tërësinë e tij. Për rrjedhojë, Kuvendi ka ndjekur procedurën e zakonshme për miratimin e tij, duke mos pasur shkelje të nenit 83, pika 3, të Kushtetutës.¹ Sipas qëndrimit tjetër, u vlerësua se dy prej dispozitave të ligjit nr. 35/2020, që miratohet me shumicë të cilësuar, sepse shton KP-në, përbëjnë në vetvete nismë të re ligjore, pasi nuk kanë lidhjen e duhur substanciale me objektin dhe qëllimin e projektligjit, tek i cili ato dy dispozita u paraqitën formalisht si amendamente. Për rrjedhojë, Kuvendi nuk ka respektuar procedurën kushtetuese të parashikuar nga neni 83 i Kushtetutës, pasi e ka miratuar këtë nismë ligjore me procedurë të përsheptuar.² Ndërsa sipas qëndrimit të tretë, u vlerësua se dispozitat ligjore të kundërshtuara nuk cenojnë ndonjë të drejtë themelore të garantuar nga Kushtetuta, për rrjedhojë kërkuesi, si subjekt i kushtëzuar, nuk legjitimohet për të kundërshtuar procedurën për miratimin e

¹ Votuan për rrëzimin e pretendimit të kërkuesit si të pabazuar gjyqtarët Vitore Tusha, Fiona Papajorgji, Altin Binaj dhe Sandër Beci.

² Votuan për pranimin e pretendimit të kërkuesit gjyqtarët Marsida Xhaferllari dhe Sonila Bejtja.

ligjit nr. 35/2020.³ Në këtë situatë të ndarjes së votave, pretendimi i kërkuesit për cenimin e shtetit të së drejtës, konsiderohet i rrëzuar në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000.

60. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit, sipas arsyetimit të mësipërm, janë pjesërisht të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, si dhe neneve 49, pika 3, shkronja “d”, 51/a, pika 1, shkronja “b” dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 2. Shfuqizimin e paragrafëve dy dhe tre të nenit 89/b të Kodit Penal.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 15.12.2022.

Shpallur më 13.1.2023.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Fiona Papajorgji

Anëtarë pjesërisht kundër: Elsa Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Altin Binaj, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (*kërkuesi*), me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të neneve 89/b dhe 242/a të Kodit Penal (KP), përveç qëndrimit të ndryshëm të shprehur në paragrafin 59 të vendimit që lidhet me parimin e shtetit të së drejtës, jemi pjesërisht kundër vlerësimit të shumicës për nenin 242/a të KP-së, pasi çmojmë se paragrafi i tretë i tij cenon lirinë personale në drejtim të kriterit të proporcionalitetit dhe barazisë para ligjit. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, parashtojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. Për sa i takon pretendimit për cenimin e lirisë personale, të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, për shkak të mosrespektimit të parimeve të proporcionalitetit dhe barazisë para ligjit, të parashikuara respektivisht nga nenet 17 dhe 18 të saj, në shtesë të vlerësimit për shfuqizimin e paragrafëve të dytë dhe tretë të nenit 89/b të KP-së (*shih paragrafët 37–39 të vendimit*), çmojmë se duhej të shfuqizohej edhe paragrafi i tretë i nenit 242/a të KP-së. Kjo dispozitë parashikon se moszbatimi i urdhrat të dhënë nga organet kompetente për karantinim ose izolimin, apo shkelja e rregullave të karantinës ose të izolimit nga personi mbartës ose jo i sëmundjes infektive, të cilit i është njoftuar ky detyrim nga autoritetet shtetërore përkatëse, dënohet me burgim nga dy deri në tre vjet.

³ Votuan për moslegjitimitimin *ratione materiae* të kërkuesit për këtë pretendimgjyqtarët Elsa Toska dhe Ilir Toska.

3. Nga përmbajtja e nenit 242/a, paragrafi i tretë, të KP-së vihet re se ai parashikon kryerjen e veprës penale në katër rrethana objektive të ndryshme “moszbatimi i urdhrit për karantinim”, “moszbatimi i urdhrit për izolim”, “shkelja e rregullave të karantinës” ose “shkelja e rregullave të izolimit”. Këto rrethana, duke mbajtur në konsideratë përkufizimin ligjor të karantinës dhe të izolimit, siç janë shpjeguar në paragrafin 50 të vendimit, bëjnë që subjekt i veprës penale të jenë tri kategori individësh “mbartësit e sëmundjes”, “të dyshuarit se janë mbartës të sëmundjes” dhe “të shëndetshmit”. Në këtë pikë duhet evidentuar se vetë norma penale parashikon shprehimisht se subjekt i veprës penale në këto rrethana mund të jetë individ mbartës ose jombartës. Në këtë mënyrë, rrethanat dhe subjektet e ndryshme të parashikuara tregojnë se neni 242/a, paragrafi i tretë, i KP-së përcakton të paktën gjashtë figura të ndryshme të veprës penale, pa marrë në konsideratë këtu llojet e ndryshme të sëmundjeve infektive në drejtim të rrezikshmërisë që ato shfaqin.

4. Ndërkohë, vihet re se ndonëse norma penale përmban një larmishmëri të konsiderueshme figurash të veprës penale, për sa i takon sanksionit, ajo parashikon vetëm llojin e dënimit me burgim me marzh dy deri në tre vjet. Parashikimi i sanksionit në këtë rast është i ndryshëm me ata të parashikuar nga neni 89/b, paragrafi i parë dhe neni 242/a, paragrafët e parë dhe të dytë, të KP-së, pasi në këto dispozita të fundit janë përcaktuar jo vetëm lloje të ndryshme dënimi (me gjobë ose me burgim), por edhe marzhe të diferencuara në mënyrë të arsyeshme të dënimit.

5. Nën këtë analizë, vlerësojmë se sanksioni penal i parashikuar në nenin 242/a, paragrafi i tretë, të KP-së jep rezultat të njëjtë për individë që gjenden në kushte objektivisht të ndryshme, duke mos respektuar në këtë mënyrë parimin themelor të barazisë para ligjit të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, sipas të cilit të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore dhe nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive. Ky parim, sipas jurisprudencës së Gjykatës, presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (*shih vendimet nr. 27, datë 29.6.2021; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 10, datë 29.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Për sa më lart, nga shqyrtimi i llojit të dënimit “vetëm me burgim” dhe marzhit të ngushtë të dënimit “dy deri në tre vjet”, në raport me rrethanat e ndryshme të kryerjes së veprës penale “moszbatimi i urdhrit për karantinim”, “moszbatimi i urdhrit për izolim”, “shkelja e rregullave të karantinës” ose “shkelja e rregullave të izolimit”, në të cilat kryhet kjo vepër penale, si dhe kategoritë e ndryshme të subjekteve “individët mbartës”, “të dyshuarit se janë mbartës” dhe “jombartësit”, çmojmë se kufizimi i lirisë personale i parashikuar nga neni 242/a, paragrafi i tretë, i KP-së nuk respekton parimet e barazisë para ligjit dhe të proporcionalitetit, duke mos e mbrojtur individin në shkallën e duhur nga arbitrariteti.

7. Thënë ndryshe, ndërhyrja e ligjvënësit në lirinë personale të individit përmes parashikimit të dënimit me burgim dy deri në tre vjet për veprën penale të parashikuar në këtë dispozitë ligjore nuk rezulton e arsyeshme, e drejtë dhe proporcionale për arritjen e objektivit legjitim të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të popullatës, nga njëra anë, por as e përligjur për trajtimin e njëjtë të individëve në kushtet e ndryshme, nga ana tjetër. Vlen të ritheksohet se kur kontrollohen aktet e pushtetit publik, sa herë që vihet në diskutim një e drejtë kushtetuese ose liri themelore, është me rëndësi të verifikohen parimet që lidhen me cilësinë e ligjit, parashikueshmërinë, sigurinë juridike dhe barazinë para ligjit, pasi janë pikërisht ato që mbrojnë individin nga arbitrariteti, veçanërisht në marrëdhëniet ndërmjet tij dhe shtetit (*shih vendimin nr. 30, datë 2.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Si përfundim, çmohet se neni 242/a, paragrafi i tretë, i KP-së duhet shfuqizuar, pasi ai cenon lirinë personale të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës për shkak të mosrespektimit të parimeve të proporcionalitetit dhe barazisë para ligjit, të parashikuara respektivisht nga nenet 17 dhe 18 të saj.

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Sandër Beci

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në çështjen me kërkesë KSHH-në, me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të neneve 89/b dhe 242/a të KP-së, në përfundim të shqyrtimit Gjykata ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin e paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 89/b të KP-së, me argumentin se për shkak të paqartësive në formulim këto norma nuk plotësojnë aspektin substancial të kriterit kushtetues “*kufizimi vendoset vetëm me ligj*” të nenit 17 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, duke mbajtur në konsideratë se mosplotësimi edhe vetëm i një kriteri e bën ligjin të papajtueshëm me Kushtetutën, Gjykata ka vlerësuar të mos analizojë më tej kriteret e tjera për këta dy paragrafë (*shih paragrafin 39 të vendimit*). Kurse në lidhje me pjesën tjetër të objektit të kërkesës, nenin 242/a të KP-së, Gjykata ka vlerësuar se kërkesa është e pabazuar, pasi ndërhyrja e ligjvënësit është realizuar përmes një mase që lejon të merren në konsideratë karakteristikat e ndryshme të kategorive të ndryshme të individëve – mbartës dhe jo mbartës, si dhe ndryshimet midis individëve në karantinë dhe individëve në izolim, ndaj kufizimi nuk rezulton të jetë i paarsyeshëm, i padrejtë dhe joproporcional (*shih paragrafin 53 të vendimit*).

2. Në kërkesën në shqyrtim një nga argumentet kryesore në mbështetje të saj është parashtruar cenimi i parimit të shtetit të së drejtës, i garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, që ndalon sipas neneve 81, pika 2 dhe 83, pika 3, të saj miratimin me procedurë të përsheptuar të ligjeve me shumicë të cilësuar. Sipas kërkesës, ndryshimet e kundërshtuara të KP-së janë miratuar nga Kuvendi me procedurë të përsheptuar, për rrjedhojë ka munguar konsultimi paraprak cilësor dhe në kohë të arsyeshme (*shih pikën 9.1. të pretendimeve të palëve*).

3. Në vlerësimin tim kërkesa duhet të ishte pranuar tërësisht, duke u shfuqizuar të dyja dispozitat e kundërshtuara nga kërkuesi, por edhe në lidhje me argumentet e vendimmarrjes jam me qasjen se kërkesa duhet të ishte pranuar pikërisht për shkak se procedura legjislative për miratimin e normave të kundërshtuara është realizuar në shkelje të neneve 81, pika 2 dhe 83, pika 3 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, duke qenë se procedura parlamentare është e vesuar vlerësimi i Gjykatës duhet të ishte ndaluar në këtë pikë, pa qenë e nevojshme analizimi i pretendimeve të tjera të parashtruara nga kërkuesi në lidhje me bazueshmërisë e tyre në themel, pra pa qenë nevoja e vlerësimit të materies së tyre.

4. Kushtetuta në nenin 78 parashikon se Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar. Nga rregulli i përgjithshëm i vendimmarrjes me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi bëjnë përjashtim tërësia e ligjeve në lidhje me të cilat, normat kushtetuese, shprehimisht, parashikojnë një shumicë të cilësuar për miratimin e tyre, të cilën hartuesit e Kushtetutës e kanë renditur në trajtën e një liste shteruese në nenin 81, pika 2, të saj (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2014; nr. 9, datë 23.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo dispozitë kushtetuese parashikon dy kritere që duhet të merren në konsideratë nga Kuvendi gjatë procesit legjislativ: i pari është i natyrës procedurale dhe konsiston në detyrimin që ka Kuvendi për miratimin e këtyre ligjeve me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij; i dyti është i natyrës lëndore, i përcaktuar nga fusha objekt rregullimi, nga ligjet konkrete të parashikuara në shkronjat “a” deri në “f”. Gjykata ka vlerësuar se parashikimi i nenit 81, pika 2,

duhet analizuar edhe në raport me rregullimet e nenit 83, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës, të cilat parashikojnë kushtet dhe kriteret për shqyrtimin dhe miratimin e një projektligji me procedurë të përshpejtuar, zbatimi i së cilës ndalohet për shqyrtimin e projektligjeve të renditura në nenin 81, pika 2, që në shkronjën “d” përfshin edhe kodet (*shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Parashikimet kushtetuese të mësipërme detajohen në Rregulloren e Kuvendit, e cila edhe pse nuk përbën lëndë gjykimi kushtetues, merret në shqyrtim në mënyrë që t’u jepet përgjigje pretendimeve për shkeljet kushtetuese në lidhje me zbatimin e procedurës legislative për miratimin e akteve ligjore.

6. Duke iu referuar pikës 3 të nenit 83 të Kushtetutës, Gjykata ka konstatuar se ky parashikim kushtetues detajohet edhe në Rregulloren e Kuvendit, e cila për ligjet që kërkojnë shumicë të cilësuar parashikon disa rregulla procedurale të ndryshme nga ato që zbatohen gjatë miratimit të ligjeve të zakonshme, konkretisht koha e diskutimeve dhe koha në dispozicion gjatë shqyrtimit nën për nen dyfishohen në rastin e ligjeve të cilësuar (nenet 48 dhe 75). Në vështtrim të këtyre rregullimeve, procedura parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të cilësuar ndjek rrjedhën e procedurës normale ligjvënëse të përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit, e cila përfshin propozimin e ligjeve, shpërndarjen e projektligjeve, raportin e komisionit përgjegjës dhe mendimet e komisioneve të tjera, propozimin e amendamenteve, tërheqjen e nismës, shqyrtimin e projektligjit në seancë plenare, përfshirë diskutimin në parim për projektligjin dhe shqyrtimin nën për nen të tij, radhën e votimit të amendamenteve dhe votimin në tërësi të projektligjit (pjesa II, kreu I dhe II, nenet 68–77). Krahas procedurës normale legislative, Rregullorja e Kuvendit, në nenin 28, përshkruan në mënyrë të detajuar rregullimin kushtetues të nenit 83, pikat 2, duke evidentuar një tërësi veprimesh procedurale që duhet të zbatohen gjatë shqyrtimit dhe miratimit të një projektligji me procedurë të përshpejtuar.

7. Konkretisht, kërkesa e Këshillit të Ministrave ose e një të pestës së deputetëve i paraqitet me shkrim Kryetarit të Kuvendit, i cili ia njofton Kuvendit në seancën plenare më të parë. Pas njoftimit të Kryetarit dëgjohet një folës pro dhe një folës kundër për jo më shumë se 10 minuta. Kryetari i Kuvendit i paraqet Kuvendit për votim projektvendimin përkatës, në të cilin përcaktohet data e shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës, afati brenda të cilit mund të propozohen amendamente dhe data e shqyrtimit në seancë plenare. Konferenca e Kryetarëve mund të përcaktojë kohën e debatit në seancë plenare, duke respektuar rregullin e parashikuar në nenin 48, pika 3, të kësaj Rregulloreje, por në asnjë rast jo më pak se 10 minuta për çdo grup parlamentar. Afati, brenda të cilit duhet të shqyrtohet çështja në komision dhe në seancë plenare, nuk mund të jetë më pak se një javë nga data e paraqitjes së kërkesës nga Kryetari i Kuvendit në seancë plenare. Kuvendi nuk mund të shqyrtojë më shumë se tri projektligje me procedurë të përshpejtuar në programin 9-javor të punës së Kuvendit dhe një projektligj në kalendarin 3-javor të punimeve të tij (*shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në vështtrim të parashikimeve të mësipërme, rregullat që zbatohen gjatë procedurave normale legislative janë thelbësisht të ndryshme nga ato të procedurave të përshpejtuara. Dallimet konceptuale midis këtyre procedurave apo edhe ndalimet përkatëse për zbatimin e tyre mbi një numër të caktuar ligjesh, kushtëzohen, veçanërisht, nga natyra e ligjeve objekt miratimi, e përcaktuar në qëllimin dhe objektin e tyre. Gjykata ka theksuar se respektimi i kriterëve formale dhe materiale që vendos Kushtetuta, gjatë procedurës ligjvënëse përbën një domosdoshmëri në shtetin e së drejtës. Referimi i drejtpërdrejtë nga Kushtetuta i mënyrës së miratimit të ligjeve organike u jep atyre fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ato renditen pas Kushtetutës dhe para ligjeve të zakonshme të Kuvendit (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2014; nr. 23, datë 8.6.2011; nr. 19, datë 3.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Legjislacioni penal ka për detyrë të mbrojë vlera të rëndësishme, të tilla si: pavarësia e shtetit dhe tërësia e tij territoriale, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendi kushtetues, prona etj (shih nenin 1/b të KP-së). Ky legjislacion është një tregues kuptimplotë për çdo vend, në kuptimin sesa ai është në gjendje të balancojë të drejtën e shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, me të drejtat dhe liritë e individit, nga ana tjetër. Në vlerësimin e Gjykatës kjo është, gjithashtu, një arsye tjetër që e ka detyruar kushtetutëbërësin të kërkojë një konsensus më të gjerë nga forcat politike të përfaqësuara në Kuvend, me qëllim që sanksionet penale të parashikohen vetëm për ato lloj veprimesh ose mosveprimesh, të cilat, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, të jenë të krahueshme për nga rëndësia me vlerat që mbrojnë (*shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në këtë kuptim, miratimi i dispozitave të reja penale, ndryshimi ose plotësimi i tyre bëhet jo vetëm me të njëjtën shumicë të cilësuar të anëtarëve të Kuvendit, por edhe në respektim të ndalimit të parashikuar në nenin 83, pika 3, të Kushtetutës, ndërkohë që mosrespektimi i kësaj procedure bie në kundërshtim me parimet e shtetit të së drejtës dhe me qëllimet e legjislacionit penal.

11. Duke iu rikthyer fakteve të çështjes konkrete në shqyrtim, rezulton se në datën 10.1.2020 në Kuvend dy deputete kanë depozituar projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, i cili synonte ndryshimin e nenit 130/a të KP-së “Dhuna në familje”. Në datën 6.2.2020 Këshilli i Ministrave ka depozituar në Kuvend nismën për një shtesë në KP, me qëllim kriminalizimin e posedimit, përdorimit, mbajtjes ose ruajtjes në mënyrë të pajustificuar të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme për të cilat është vendosur konfiskimi, sipas legjislacionit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Gjatë kohës që projektligji i propozuar nga dy deputetet ishte në proces diskutimi, në datën 8.4.2020, një deputete tjetër, bazuar në nenin 71 të Rregullores së Kuvendit, ka depozituar propozime për amendamente në projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”, me qëllim shtimin e dy neneve të reja në KP, përkatësisht nenet 242/1 dhe 242/2, të cilat lidheshin me situatën e pandemisë COVID-19. Pas diskutimeve në komisionin parlamentar përgjegjës u vlerësua që projektligji të përfshinte vetëm propozimet e deputeteve, ndërsa nisma e Këshillit të Ministrave të shqyrtohej më vonë. Në datën 16.4.2020 Kuvendi, mbështetur në nenet 81, pikat 1 dhe 2 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, ka miratuar ligjin nr. 35/2020 (*shih paragrafët 1-4 të vendimit*), me të cilin, përveç ndryshimeve në nenin 130/a, janë shtuar edhe dispozitat e kundërshtuara, konkretisht me nenin 2 të këtij ligji, pas nenit 242 është shtuar neni 242/a “Moszbatimi i masave të autoriteteve shtetërore gjatë gjendjes së masave të jashtëzakonshme apo gjatë gjendjes së epidemisë”, kurse me nenin 3, pas nenit 89/a është shtuar neni 89/b “Përhapja e sëmundjeve infektive”.

12. Në vlerësimin tim, edhe pse formalisht procedura e ndjekur për miratimin e ndryshimeve të kundërshtuara të KP-së nuk referon në përmbajtjen e nenit 28 të Rregullores së Kuvendit, i cili në pikën 2 nuk lejon zbatimin e saj për shqyrtimin e projektligjeve që kërkojnë shumicë të cilësuar, të parashikuara në nenin 81, pika 2, të Kushtetutës, në thelb kjo procedurë, për mënyrën se si është zhvilluar që nga propozimi i ndryshimeve, përfshirja në diskutimet e komisionit parlamentar dhe më pas votimi në seancë plenare, duke u paraqitur si një propozim për ndryshim amendamenti dhe jo si një nismë e re, ka çuar në miratimin e këtyre dispozitave penale, në thelb, me procedurë të përshpejtuar, si dhe në mosrespektimin e ndalimit kushtetues dhe të dispozitave të Rregullores së Kuvendit.

13. Neni 68, pika 2, i Rregullores së Kuvendit parashikon kërkesat në lidhje me formën dhe dokumentet shoqëruese të projektligjit, kurse sipas neneve 69 dhe 70, projektligjet, pasi regjistrohen në një regjistër të veçantë, i kalohen Kryetarit të Kuvendit, i cili urdhëron menjëherë shpërndarjen e tyre deputetëve dhe në përputhje me programin e punës dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit i

dërgon për shqyrtim në komisionin përgjegjës dhe në komisionet që sipas kësaj Rregulloreje duhet të paraqesin mendimin e tyre. Pas shqyrtimit të projektligjit, komisioni përgjegjës harton një raport për në seancë plenare, duke bërë propozimin për miratimin e tij siç është paraqitur, miratimin me ndryshime ose rrëzimin e projektligjit. Sipas nenit 71, çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të propozojë amendament/te gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës, i cili paraqitet me shkrim dhe i arsyetuar. Këto dispozita të Rregullores kanë përcaktuar edhe afatet për secilën etapë të procedurës parlamentare. Ndërsa nisma ligjvënëse kërkon plotësimin e kriterëve si më sipër dhe ndjek procedurën e parashikuar nga këto dispozita të Rregullores, propozimi për amendamente është një procedurë e ndryshme, që ka të bëjë me propozime në lidhje me projektligjin dhe që mund të jenë shtesa ose ndryshime në përmbajtjen e dispozitave që përmban projektligji i depozituar në Kuvend.

14. Në këtë kuptim, për sa kohë që dy dispozitat e reja të KP-së nuk kanë qenë pjesë e nismës së deputetëve për procedurat parlamentare dhe nuk lidhen me ndryshimet e propozuara, ato duhej t'i ishin nënshtruar procedurës së zakonshme parlamentare, sipas rregullave dhe afateve të dispozitave të sipërcituara. Në të njëjtën linjë me këtë qëndrim, edhe pse kishim të bënim me të njëjtin akt ligjor (KP-në), nisma e deputetëve për ndryshimin e nenit 130/a të KP-së "Dhuna në familje" dhe ajo për një shtesë në këtë kod me qëllim kriminalizimin e posedimit, përdorimit, mbajtjes ose ruajtjes në mënyrë të pajustificuar të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme për të cilat është vendosur konfiskimi, sipas legjislacionit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, janë paraqitur si nisma më vete në Kuvend dhe në këtë mënyrë i janë nënshtruar edhe procedurave parlamentare.

15. Duke pasur parasysh përmbajtjen e dispozitave penale të miratuara me ligjin nr. 35/2020, ndërsa nisma ligjore e deputetëve nismëtare kishte të bënte me disa ndryshime në nenin 130/a, që ka të bëjë me veprën penale "Dhuna në familje", dispozitat e tjera të miratuara nga Kuvendi kanë të bëjnë me vepra të tjera penale, të cilat nuk kanë lidhjen e duhur substanciale me objektin dhe qëllimin e projektligjit, tek i cili ato dy dispozita u paraqitën formalisht si amendamente. Për rrjedhojë, nismat për shtimin e nenit 242/a, që parashikon kundërvajtjen penale të moszbatimit të masave të autoriteteve shtetërore gjatë gjendjes së masave të jashtëzakonshme ose gjatë gjendjes së epidemisë, dhe të nenit 89/b, që parashikon veprën penale të përhapjes së sëmundjeve infektive, përbëjnë nisma të reja ligjore, për të cilat ishte e detyrueshme të respektohej procedura e miratimit (duke pasur parasysh që këto janë vepra të reja penale që integrohen në KP), pra duke respektuar si procedurën, ashtu edhe shumicën e kërkuar për miratimin e ndryshimeve në kode.

16. Duke u trajtuar propozimet e reja penale si amendamente të një propozimi që tashmë ishte në shqyrtim në komisionin përkatës dhe në pritje të kalimit për shqyrtim në seancë plenare, nuk janë respektuar kërkesat kushtetuese për miratimin e ligjeve të cilësuar. Për rrjedhojë, miratimi nga Kuvendi i projektligjit në kapërcim të kriterëve procedurale, përbën një të metë *in procedendo* të vetë ligjit, çka është e mjaftueshme për shfuqizimin e tij si i papajtueshëm me Kushtetutën, pa pasur nevojë për të vazhduar më tej me vlerësimin e bazueshmërisë në themel të pretendimeve të tjera të parashtruara në kërkesë.

Anëtar: Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të iniciuar nga kërkuesi Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ne gjyqtarët në pakicë, kemi votuar për rrëzimin në tërësi të kërkesës. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje për shfuqizimin e paragrafëve të dytë dhe

të tretë të nenit 89/b të KP-së, dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

2. Në mënyrë të përmbledhur, ne vlerësojmë se kontrolli kushtetues dhe shfuqizimi i normave juridike duhet të ushtrohen jo thjesht kur ka paqartësi juridike, por kur niveli i këtyre paqartësive është i tillë që nuk mund të interpretohet me praktikë gjyqësore, si dhe kur niveli i paqartësive *ka sjellë* ose *mund të sjellë* pasoja antikushtetuese për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat nuk mund të korrigjohen përveçse me shfuqizim të normës juridike. Në këtë kontekst: *së pari*, paqartësitë e paragrafëve të dytë dhe të tretë të nenit 89/b të KP-së, objekt gjykimi, nuk janë të nivelit kushtetues të atillë që të mund të sjellin cenim të të drejtave themelore të njeriut në drejtim të kufizimit të lirisë personale të lidhur me kriterin substancial “kufizimi vendoset vetëm me ligj”; *së dyti*, paragrafi i dytë i nenit 89/b ka probleme të natyrës sistematike ose strukturore, ndërsa për paragrafin e tretë të nenit 89/b të KP-së mund dhe duhej të aplikohet një interpretim pajtues, mes disa llojeve të interpretimeve; *së treti*, duke shfuqizuar ligjet vetëm duke u nisur nga kriteri se ligji edhe pse ekziston formalisht, në fakt në substancë ka mangësi që e bëjnë të paqartë ose të pasaktë dhe për këtë arsye kriteri “vetëm me ligj” për kufizimet nuk përmbushet, e kthen kontrollin kushtetues në një kontroll cilësie formal mbi ligjet, që nuk u jep kohë dhe mundësi organeve gjyqësore ta zbatojnë atë dhe ta përmirësojnë kuptimin e normës, përmes interpretimit gjyqësor si kompetencë kushtetuese e tyre.

3. Konkretisht, shumica ka argumentuar, lidhur me paragrafin e dytë të nenit 89/b të KP-së, se: “... Gjykata vëren se në paragrafin e dytë neni 89/b parashikon, se: “*kur kjo veprë është kryer nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet*”. Ky formulim e nxjerr veprën penale nga sistemi i atyre të kryera me dashje, pa dhënë ndonjë arsye se përse nuk është vendosur te Seksioni IV, i cili përmbledh veprat penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia. Ndonëse në vetvete, pozicionimi sistematik i një dispozite ligjore nuk përbën argument të mjaftueshëm për antikushtetutshmërinë e saj, Gjykata vëren se në rastin konkret ky formulim nuk i jep përgjigje të saktë as çështjes së përgjegjësisë penale të individit. Togfjalëshi “*kur kjo veprë*” nuk kuptohet nëse i referohet përmbajtjes së paragrafit të parë të nenit 89/b ose vetëm titullit të tij. Nëse ajo i referohet përmbajtjes së paragrafit të parë, atëherë është e paqartë se si mund të kryhet nga pakujdesia vepra penale e përhapjes së sëmundjes infektive të rrezikshme nga personi që ka për qëllim përhapjen e saj, ndërsa nëse i referohet thjesht dhe vetëm titullit “*Përhapja e sëmundjes infektive*”, atëherë është e paqartë nëse bëhet fjalë për çdo lloj sëmundje infektive ose vetëm për ato të rrezikshmet. Po kështu, duke pasur parasysh kuptimin e fajit në formën e pakujdesisë, formulimi i krijon individit pasiguri për masat që duhet të marrë për të kontrolluar shëndetin dhe diagnostikimin e sëmundjeve eventuale epidemike, që të provojë se nuk ka pasur mundësi as të parashikonte dhe as të dëshironte përhapjen e sëmundjeve infektive. Me fjalë të tjera, nga ky formulim nuk kuptohet se si individit duhet të veprojë për të parashikuar mundësinë e ardhjes së pasojës penale – përhapjen e sëmundjes infektive, me qëllim shmangien e përgjegjësisë penale. (...) (shih prg. 37 të vendimit).

4. Lidhur me paragrafin e tretë të nenit 89/b, shumica argumenton, se: “...Gjykata konstaton paqartësi edhe në përmbajtjen e paragrafit të tretë të nenit 89/b, i cili parashikon se “*po kjo veprë, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin ose rrezik për jetën e njerëzve, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet*”. Togfjalëshi “*po kjo veprë*” në këtë paragraf është sërish i paqartë nëse i referohet veprës penale të paragrafit të parë, veprës penale të paragrafit të dytë ose thjesht titullit të të gjithë nenit. Nëse i referohet paragrafit të parë, atëherë është e paqartë se ku ndryshojnë këto dy vepra penale nga njëra-tjetra, në kushtet kur sëmundja infektive me rrezikshmëri të lartë për shëndetin nëse përhapet do të shkaktojë pasoja të rënda për shëndetin ose rrezik për jetën e njerëzve. Ndërsa nëse i referohet paragrafit të dytë ose titullit të nenit 89/b, atëherë lindin të njëjtat paqartësi të evidentuara gjatë analizës së paragrafit të dytë. (...) (shih prg. 38 të vendimit).

5. Përfundimisht, ajo konkludon: “Për rrjedhojë, Gjykata çmon se paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 89/b të KP-së, për shkak të paqartësive në formulim, nuk plotësojnë aspektin substancial të kriterit kushtetues *“kufizimi vendoset vetëm me ligj”* të nenit 17 të Kushtetutës. Duke mbajtur në konsideratë se mosplotësimi edhe vetëm i një kriteri e bën ligjin të papajtueshëm me Kushtetutën, Gjykata vlerëson të mos analizojë më tej kriteret e tjera për këta dy paragrafë *(shih prg. 39 të vendimit)*.

6. Në vlerësimin tonë, argumentet e ngritura nga shumica nuk janë të mjaftueshme në tërësi ose edhe veç e veç për shfuqizimin e paragrafëve të dytë dhe të tretë të nenit 89/b të KP-së, objekt gjykimi, pasi nuk janë të mbështetura në standardet kushtetuese të kriterit substancial të kufizimit *“vetëm me ligj”* *(shih prg. 34 të vendimit)*.

7. Duhet theksuar fillimisht se vetë kërkesja nuk ka pretenduar cenim të kriterit substancial *“vetëm me ligj”*, por cenim të parimit të sigurisë juridike *(shih prg. 9.2 të vendimit)*. Po ashtu, gjatë seancës plenare rezultoi se nuk ka pasur ose nuk u paraqit asnjë çështje penale, ku të jenë ndeshur problematikat e pretenduara nga kërkesja gjatë zhvillimit të proceseve pranë organeve penale ose gjyqësore *(shih procesverbalin e seancës gjyqësore)*. Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve ajo niset nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se lidhur me antikushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrohen argumente bindëse për t'i dhënë mundësi kësaj Gjykate të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese *(shih vendimet nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 4, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë kontekst, kërkesja nuk ka arritur të provojë në këtë gjykim se normat objekt kundërshtimi kanë probleme antikushtetutshmërie, pra të përmbyste prezumimin e kushtetutshmërisë së normave të kundërshtuara.

8. Neni 89/b i KP-së, paragrafët 1, 2 dhe 3, parashikon: *“Përbapja me dashje e sëmundjes infektive me rrezikshmëri të lartë për shëndetin, nëpërmjet kryerjes së veprimeve ose mosveprimeve nga personi që është diagnostikuar si mbarëtës i sëmundjes apo nga personi që ka qëllim përbapjen e saj, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Kur kjo vepër është kryer nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.*

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin ose rrezik për jetën e njerëzve, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet”.

9. Siç ka pohuar edhe Gjykata, fakti që një dispozitë ligjore mund të ketë më shumë se sa një mënyrë interpretimi, nuk e bën atë të paqartë. Përkundrazi, ligji nuk duhet të jetë shterues dhe i ngurtë, por duhet t'u lërë hapësirë interpretimi organeve administrative dhe gjyqësore, në varësi të rrethanave konkrete dhe zhvillimit të normave në kontekst të praktikës *(shih vendimin nr. 20, datë 20.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese, prg. 113)*.

10. Nga ana tjetër, Gjykata ka shqyrtuar dy çështje, së fundmi, dhe ka pranuar kërkesën e kërkesve për shfuqizim të normave ligjore vetëm mbi kriterin *“me ligj”* në kuptimin substancial të kufizimit sipas nenit 17 të Kushtetutës. Gjykata është shprehur se *“duke i përmbledhur vlerësimet e mësipërme për aspektin substancial, Gjykata çmon se edhe pse në nenin 131 të ligjit nr. 108/2014 janë bërë disa parashikime për kufizimin që i vendoset së drejtës së jetës private, këto parashikime nuk janë formuluar në mënyrë cilësore, siç kërkon ky aspekt i kriterit kushtetues “kufizimi vendoset vetëm me ligj” të nenit 17 të Kushtetutës. Parashikimet e nenit 131 janë me mangësi dhe të paqarta, në atë masë që bien ndesh me shtetin e së drejtës dhe parimin e sigurisë juridike, duke mos respektuar koherencën e rendit juridik. Në këtë mënyrë, ligji nuk ofron garancitë e mjaftueshme që të mënjanojnë mundësitë për abuzim dhe arbitraritet të autoriteteve publike për të drejtën kushtetuese të jetës private”* *(shih vendimin nr. 30, datë 12.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese, prg. 64)*.

11. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se *“...dispozita duket se bën të zbatueshme të njëjtat rregulla ligjore për kamatat me ato për titujt ekzekutivë “kredi bankare” për qëllime të veprimtarisë tregtare, ndonëse këto dy kategori kredimarrësish janë të ndryshme. Gjithashtu, formulimi i dispozitës së kundërshtuar ia delegon pa përjashtim përllogaritjen e kamatave ligjore për titujt ekzekutivë “kredi*

konsumatore” dhe “kredi tregtare” rregullave të ligjit nr. 48/2014, ndonëse ky i fundit shprehimisht përjashton nga fusha e zbatimit të tij detyrimet ose pagesat që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët. Në këtë mënyrë, dispozita e kundërshtuar nuk përmbush kriterin e parashikueshmërisë së kërkuar nga parimi i sigurisë juridike në rastin e ndërhyrjeve që bën ligjvënësi në të drejtat kushtetuese, përfshirë të drejtën e pronës. Duke i përmbledhur vlerësimet e mësipërme për aspektin substancial, Gjykata çmon se neni 511, paragrafi i pestë, shkronja “d”, i KPC-së nuk është formuluar në mënyrë cilësore, siç kërkon ky aspekt i kriterit kushtetues “kufizimi vendoset vetëm me ligj” të nenit 17 të Kushtetutës. Duke mbajtur në konsideratë se mosplotësimi edhe vetëm i një kriteri e bën ligjin të papajtueshëm me Kushtetutën, analiza e kriterit të proporcionalitetit është e panevojshme. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se është i bazuar pretendimi i gjykatës referuese se dispozita e kundërshtuar cenon të drejtën kushtetuese të pronës, në vështrim të mënyrës si kjo dispozitë përcakton detyrimin e përllogaritjes së kamatës ligjore për titullin ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare konsumatore.” (shih vendimin nr. 30, datë 12.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese, prg. 58–60).

12. Nga jurisprudenca e sipërcituar, “kufizimi me ligj në aspektin substancial” është kriter i cili nëse nuk plotësohet, mund të arrihet në konkluzionin se ka antikushtetutshmëri, por mbi premisën që paqartësia apo paparashikueshmëria është e tillë që sjell ose mund të sjellë pasoja mbi të drejtat themelore të njeriut. Kriteri kushtetues “kufizim me ligj në kuptimin substancial”, sipas nenit 17 të Kushtetutës dhe jurisprudencës në zhvillim të Gjykatës për këtë standard, nuk mund të zërthehet duke u nisur vetëm nga paqartësitë, pa marrë në konsideratë interpretimin gjyqësor përmes gjykatave të zakonshme, që është një rol i pazëvendësueshëm për bërjen e ligjeve të parashikueshme dhe të aksesueshme nga individët.

13. Po në këtë drejtim, edhe GJEDNJ-ja është shprehur se sado e qartë të jetë një dispozitë ligjore, në çdo sistem ligjor, përfshirë edhe atë penal, ekziston një element i pashmangshëm i interpretimit gjyqësor. Gjithmonë do të ketë nevojë për sqarim të pikave të dyshimta dhe përshtatje me ndryshimin e rrethanave. Roli i gjykatave është pikërisht për të larguar dyshime të tilla interpretuese. Zhvillimi progresiv i ligjit penal përmes krijimit të ligjit nëpërmjet praktikës gjyqësore është një pjesë e ngulitur mirë dhe e domosdoshme e traditës juridike në shtetet e Konventës (shih *Del Río Prada kundër Spanjës*, §§ 92–93; *Vasiliauskas kundër Lituanisë*, § 155). Një ligj mund të përmbushë kriterin e parashikueshmërisë edhe nëse personi i interesuar duhet të marrë këshilla të përshtatshme ligjore nga një avokat për të vlerësuar pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar (shih *Lekić kundër Sllovenisë* [GC], § 97). Problemet e parimit të sigurisë juridike shpesh shfaqen kur autoritetet nuk bien dakord se si duhet të interpretohen dhe zbatohen dispozitat ligjore. Kompleksiteti në ligjin kombëtar nuk do të thotë se nuk ka siguri. Ai që mund të duket se është një tekst i pakuptueshëm, mund të ndodhë që të ofrojë udhëzime të parashikueshme për një person të ndaluar, “nëse është e nevojshme me këshillën e një avokati” (shih *Mooren kundër Gjermanisë*, [GC], nr. 11364/03, § 91, 9 korrik 2009). Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja ka theksuar se kriteri i parashikueshmërisë shpesh ndërthuret me kërkesat/kriteret e mungesës së arbitraritetit dhe masave mbrojtëse procedurale. Kështu, një normë juridike është “e parashikueshme” kur ofron një masë mbrojtjeje nga ndërhyrjet arbitrare të autoriteteve publike. Për të konstatuar nëse ai kriter është përmbushur, duhet të shqyrtohen në një vështrim gjithëpërfshirës procedurat gjyqësore dhe administrative në fuqi (shih *Lekić kundër Sllovenisë* [GC], § 95; *Jokela kundër Finlandës*, § 45; *Capital Bank AD kundër Bullgarisë*, § 134; *Stolyarova kundër Rusisë*, § 43).

14. Për rrjedhojë, pavarësisht paqartësive që mund të lindin nga interpretimi i dispozitës së kundërshtuar, cilësia e ligjit nuk përbën gjithmonë shkak për shfuqizim, pasi përmbajtja e tij mund të lexohet në dritën e interpretimit të kryer nga praktika gjyqësore. Kur formulimi i një dispozite nuk është mjaft i qartë dhe krijon pasiguri e paqartësi, duhet të shqyrtohet nëse kuptimi i kësaj dispozite

është sqaruar ose mund të sqarohet përmes interpretimit nga autoritetet administrative dhe gjyqësore.

15. Në këtë kontekst, edhe pse e pranojmë që paragrafët objekt kundërshtimi kanë krijuar një lloj paqartësie, në fakt kjo gjetje nuk shoqërohet me mungesën e një zgjidhjeje të qartë, pasi zgjidhja, sidomos për paragrafin e tretë të nenit 89/b të KP-së, është interpretimi pajtues, i cili si metodë dhe teknikë, nëse do të zbatohet nga shumica në këtë gjykim, e neutralizon paqartësinë, e cila nuk ishte e nivelit të tillë kushtetues që të shfuqizohej.

16. Në këtë drejtim, në vlerësimin e kushtetutshmërisë të ligjeve, Gjykata niset nga prezumimi i kushtetutshmërisë së tyre me Kushtetutën, si dhe mundësia e interpretimit pajtues të tyre. Interpretimi pajtues është i mundur kur një ligj apo dispozitë ligjore mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë, njëra nga të cilat është në pajtim me Kushtetutën. Kjo metodë kërkon efektet kushtetuese të rezultateve të ndryshme dhe përzgjedh rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat themelore të individëve (*shih vendimet nr. 5, datë 16.2.2012; nr. 33, datë 24.6.2010; nr. 29, datë 31.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata niset nga premisa që një akt normativ duhet të interpretohet në kuptimin që lejon zbatimin e tij, jo në atë që e përjashton këtë zbatim (*actus interpretandus est potius ut valeat quam ut pereat*) (*shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016 i Gjykatës Kushtetuese*).

17. Interpretimet pajtuese, si teknikë interpretative, Gjykata, gjatë jurisprudencës së saj, i ka përdorur edhe në rastet kur para saj janë kundërshtuar ligjet e fushës penale (*shih vendimet nr. 37, datë 19.9.2011; nr. 26, datë 13.6.2011; nr. 30, datë 17.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Duke iu kthyer analizës së normave të shfuqizuara, konstatohet se paragrafi i dytë i nenit 89/b të KP-së nuk është renditur te veprat penale që shkaktohen nga pakujdesia, pra ka një problematikë teknike legislative. Megjithatë, Gjykata ka theksuar se Kodi Penal përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përfshihen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike. Një nga parimet kryesore që përshkon këtë kod është edhe parimi i ligjshmërisë që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale dhe mosdënimin për një vepër penale që nuk është parashikuar shprehimisht si krim ose kundërvajtje penale. Dispozita që e klasifikon një veprim të caktuar si vepër penale jashtë dispozitave të Kodit Penal dhe si pjesë e një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë të deputetëve, bie ndesh me parimin e kushtetutshmërisë, pasi prek drejtpërdrejt shtetasit në të drejtat dhe liritë e tyre, duke mos respektuar shumicën e cilësuar për këtë qëllim, të parashikuar nga neni 81, pika 2, të Kushtetutës. Shpërndarja e normave juridiko-penale në ligje të ndryshme, si dhe ndryshimet e shpeshta në legjislacionin penal, nuk i shërbejnë stabilitetit juridik të vendit, si një kusht i rëndësishëm për funksionimin e shtetit të së drejtës (*shih vendimet nr. 3, datë 5.2.2010; nr. 1, datë 12.1.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në vështrim të këtyre standardeve mund të shfuqizohet një dispozitë, pasi veprat penale janë të shpërndara në ligje të ndryshme, të cilat janë miratuar edhe me shumicë të thjeshtë, pra problematikë e natyrës kushtetuese. *A contrario*, shpërndarja e veprave brenda vetë KP-së në seksione të ndryshme, jo vetëm që nuk mund të përbëjë argument të mjaftueshëm për shfuqizim në vetvete, por as nuk duhet të konsiderohet si mangësi e natyrës kushtetuese. Për më tepër, argumentet e tjera të dhëna nga shumica, për paqartësitë mbi çështjen e përgjegjësisë penale të individit, lidhen me individualizimin e dënimit nga gjykatat rast pas rasti. Ashtu sikundër kjo gjykatë ka theksuar: “ ... dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, nga njëra anë, dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Në këtë drejtim, përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve janë në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale (...) vlerësimi i tërësisë së faktit penal, në lidhje me të gjitha elementet dhe rrethanat

që e përbëjnë atë, me qëllim individualizimin e shkallës së përgjegjësisë të të pandehurit dhe përshtatshmërinë e dënimit, hyn në fushën e diskrecionalitetit të gjyqtarit të faktit...” (shih vendimet nr. 9, datë 26.2.2016; nr. 12, datë 19.3.2015; nr. 47, datë 26.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

20. Në vijim, lidhur me paragrafin e tretë, ku parashikohet se kur *kjo vepër ka shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin ose rrezik për jetën e njerëzve, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet*, ndryshe nga shumica që është e paqartë nëse me shprehjen “kjo vepër” i referohet veprës së parashikuar në paragrafin e parë të nenit apo paragrafit të dytë, ne vlerësojmë se mund të ketë disa mënyra interpretimi të saj. Në zbatim të interpretimit pajtues, shprehja “kjo vepër” mund të kuptohet se i referohet vetëm paragrafit të parë, (përhapja me dashje), pra përjashtohet kjo vepër kur është kryer nga pakujdesia (paragrafi i dytë i nenit). Ky përjashtim duhet bërë me qëllim që mos të sjellë pasoja antikushtetuese në drejtim të individualizimit dhe marzheve të dënimit penal. Kështu, nëse do i referohej edhe paragrafit të dytë (kur vepra kryhet nga pakujdesia dënohet me gjobë ose burgim deri në 2 vjet), do të rezultonte masa e dënimit edhe më e lartë se sa vrasja nga pakujdesia, që në fakt referuar nenit 85 të KP-së marzhin e dënimit e ka më të ulët (vrasja e kryer nga pakujdesia dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet).

21. Nga leximi tërësor i të dy paragrafëve të nenit 89/b të KP-së, paqartësitë dhe pasaktësitë janë më tepër problematike që vjen nga teknika legjislative, se sa me pasoja negative ndaj së drejtës së individit për liri personale, në kuptim të kriterit të parë të kufizimit të nenit 17 të Kushtetutës, mbi të cilën u vlerësua papajtueshmëria me Kushtetutën, duke mos u ndalur në analizën më tej me kriteret e tjera për këto dy paragrafë. (shih prg. 30, prg. 39 të vendimit). Për rrjedhojë, shumica ka mbajtur një qasje formaliste, pa efekt të drejtpërdrejtë mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut në kuptimin kushtetues, përveçse duke përçuar një qëllim edukues ndaj ligjvënësit në bërjen e ligjeve.

22. Për të gjitha sa më lart, vlerësojmë se kërkesa duhej rrëzuar në tërësi, për shkak se nuk u provua cenimi i të drejtave kushtetuese. Për më tepër, në vlerësimin tonë, prania e interesit për çështjen është e kushtëzuar me pranimin në përfundim të gjykimit edhe të pretendimit të ngritur mbi të drejtat kushtetuese, të cilat kjo organizatë mbron dhe për të cilat u legjitimua. Në këtë kuptim, duke pasur parasysh se kërkesja është subjekt i kushtëzuar, dhe dallimi mes dy kategorive të subjekteve, sipas nenit 134 të Kushtetutës, duhet të vazhdojë të respektohet në përputhje me standardet jurisprudenciale ndër vite (shih vendimet nr. 20 datë 20.4.2021, nr. 4, datë 23.2.2011, të Gjykatës Kushtetuese) përderisa nuk ka cenim të të drejtave dhe lirive kushtetuese, ajo nuk legjitimohet për pretendimet mbi shtetin e së drejtës, në kuptim të cenimit të procedurave parlamentare të ndjekura mbi ligjin.

Anëtarë: Ilir Toska, Elsa Toska